

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5973
E shtunë, 11 janar 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria ndan 250 mijë euro për koalicionin global për luftën kundër terrorizmit I FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, I KA SHKRUAR LETËR LIDERIT TË LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI I FAQE 4-5

PRESIDENTI I KËRKON VETËVENDOSJES MANDATARIN PËR FORMIMIN E QEVERISË

OPINION

PËR KRIZËN SHOIPËRI - IRAN: AS PANIK, AS EUFORI, POR MË SHUMË VIGJILENCË DHE SIGURI F. 11

Prof. Lisen BASHKURTI



PËRSE MË ËSHTË KUJTUAR XHAVIT HOXHA? F. 11

Nga Bedri ISLAMI



AKTUALE

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN KA ZGJIDHUR 13 605 LËNDË F. 6

EKONOMI

MOSMIRATIMI I BUXHETIT VË NË HALL BIZNESET F. 9

KAPEN RRETH 600 LITRA PIJE ALKOOLIKE TË KONTRABANDUARA F. 8


KULTURË

"SOFRA" MBETET E SHTRUAR... F. 14

Sadri FETIU



AMBASADORI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË AUSTRI, Z. SAMI UKELLI, NDEROI VEPRIMTARIN E MADH DHE SHKENCËTARIN PROF. DR. EQREM ZENELAJ F. 14



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ia ka kërkuar të premtën Lëvizjes Vetëvendosje (LV) emrin e kandidatit për kryeministër. Përmes një letre drejtuar liderit të LV-së, Albin Kurti, presidenti ka kërkuar që të njoftohet nëse Vetëvendosja do ta dorëzojë emrin e mandatarit për

kryeministër apo do të refuzojë ta bëjë një gjë të tillë. Kjo e fundit nuk i është përgjigjur letrës së presidentit. Ndërsa njohësit e proceseve politike letrën e presidentit Thaçi e kanë parë si presion politik ndaj Kurtit për të arritur sa më shpejt marrëveshje me LDK-në

Haradinaj: Partia e parë e formon qeverinë I FAQE 3

Shoqata 'Bereqeti' vazhdon t'i ndihmojë familjet në nevojë I FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz - Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Yuri Kim bën betimin si ambasadore e ShBA-së në Shqipëri

UASHINGTON, 10 JANAR - Yuri Kim bëri të enjten betimin si ambasadore e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri. Kim, u emërua nga presidenti Donald Trump në qershor të këtij viti. Ajo ka thënë se do t'i nxisë udhëheqësit e Shqipërisë për të zgjidhur ngërçin aktual politik në mënyrë që të forcohet perspektiva e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE. Kim ka thënë gjithashtu se do të inkurajojë Shqipërinë t'i zbatojë plotësisht reformat në drejtësi. Ajo është shprehur se shih si përparësi edhe ndihmën teknike për Shqipërinë në het-

imin, ndjekjen dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar ndërnacional. Kim pritet gjithashtu të inkurajojë Shqipërinë për të arritur nivelin 2 për qind në shpenzimet e mbrojtjes deri në vitin 2024.

Yuri Kim është gruaja e parë koreano-amerikane që përfaqëson ShBA-në në postin e një ambasadori dhe personi i parë nga territori amerikan i Guamit që shërben në një post të tillë. Ajo ka lindur në Kore dhe është rritur në ishullin Guam, një territor i ShBA-së në Oqeanin Paqësor.

Ajo ka shërbyer në

Departamentin e Shtetit si drejtoreshë e Zyrës së Çështjeve të Evropës Jugore, ka qenë drejtoreshë e Qendrës së Departamentit të Shtetit për Studimin e Diplomacisë, shefe e Stafit për zëvendëssekretarin e Shtetit dhe drejtoreshë e Zyrës për Sigurinë Evropiane dhe Çështjeve Politiko-Ushtarake.

Ndërkohë, Ambasada amerikane në Tiranë ka njoftuar të premten në mbrëmje se ambasadorja amerikane Yuri Kim, në javët e ardhshme do të arrijë në Tiranë. "Presim me kënaqësi që t'i urojmë



mirëseardhjen në Shqipëri në javët e ardhshme", thuhet në njoftimin e Ambasadës amerikane në Tiranë, ndërsa bëri të ditur se Yuri Kim u betua të

enjten si ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, gjatë një ceremonie zyrtare në Departamentin e Shtetit.

Leyen: Periudhë e rëndësishme për raportet BE - Ballkan

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se muajt e ardhshëm janë të rëndësishëm sa iu përket raporteve të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroacia është një mbështetëse e madhe e kësaj çështjeje

ZAGREB, 10 JANAR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se muajt e ardhshëm janë të rëndësishëm sa iu përket raporteve të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor. "Muajt e ardhshëm janë veçanërisht të rëndësishëm për marrëdhëniet tona me Ballkanin. Kroacia është një mbështetëse e madhe e kësaj çështjeje", tha presidentja e KE-së. Ajo i bëri komentet në Zagreb të Kroacisë, në një konferencë për media së bashku me kryeministrin Andrej Plenković.

Presidentja e Komisionit Evropian u zotua për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. "Këto vende kanë përmbushur kriteret dhe ne duhet të përmbushim pre-

timin tonë", tha ajo, duke shtuar se BE-ja nuk duhet t'i ndryshojë kushtet për këto vende, por vetëm të përmirësojë metodologjinë e negociatave.

Leyen ka bërë të ditur edhe për mbajtjen e konferencës së donatorëve për të ndihmuar Shqipërinë pas tërmetit. "Konferenca e donatorëve vjen pas tërmetit të tmerrshëm, që goditi Shqipërinë. Ne duam ta ndihmojmë Shqipërinë në rindërtimin e vet", tha Von der Leyen.

Menjëherë pas tërmetit të 26 nëntorit, që shkaktoi 51 të vdekur, një mijë të plagosur 14 mijë të pastrehë dhe mijëra ndërtesa të shkatërruara, Komisioni Evropian i dha Shqipërisë një grant fillestar prej 15 milionë eurosh.

BE-ja, Kombet e Bashkuara dhe



Banka Botërore lëshuan një thirrje për ndihmë pas tërmetit në mes të dhjetorit, të cilat do të përbyllën në konferencën e donatorëve. Ky plan i përbashkët do të qëndrojë në themel të përpjekjeve për rindërtim.

Në këtë proces janë angazhuar të marrin pjesë, krahas vendeve anëtare të BE-së, partnerëve të

Ballkanit Perëndimor, edhe vende të tjera, organizata dhe institucione financiare ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara dhe Banka Botërore. Ndërkohë, kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla tha të premten se presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen njoftoi Konferencën ndërkom-

bëtare të donatorëve për rindërtimin e Shqipërisë pas tërmetit të 26 nëntorit.

Balla ka thënë se kjo konferencë e rëndësishme do të zhvillohet më 17 shkurt 2020 në Bruksel, duke u shprehur mirënjohje institucioneve të Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare për solidaritetin me Shqipërinë.

Cakaj: Kosova ka përmbushur kriteret për heqjen e vizave

VJENË, 10 JANAR - Ministri në detyrë i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Gent Cakaj, ka bërë me dije se është takuar me homologun austriak, Alexander Schallenberg, me të cilin ndër të tjera ka diskutuar edhe për Kosovën.

Cakaj i ka thënë kryediplomatit austriak se Kosova ka përmbushur të gjitha detyrimet për liberalizimin e vizave. "Gjatë qëndrimit në Vjenë zhvillova

edhe një takim dypalësh me ministrin e Jashtëm të Austrisë, Alexander Schallenberg. Në takim diskutuam për prioritet kryesorë të Kryesisë shqiptare të OSBE-së 2020 dhe angazhimet e përbashkëta në funksion të sigurisë dhe zhvillimeve demokratike. Po ashtu, biseduam edhe për domosdoshmërinë e çeljes së negociatave për anëtarësim në BE me Shqipërinë dhe Maqedoninë e

Veriut gjatë këtij viti. Një mirënjohje e veçantë për mbështetjen e jashtëzakonshme që Austria i ka dhënë Shqipërisë në angazhimet e saj për OSBE-në dhe në procesin e integritimit në BE. Në fund, nënvizuam edhe njëherë faktin se Kosova ka përmbushur të gjitha detyrimet e saj për të marrë liberalizimin e vizave një orë e më parë", ka shkruar Cakaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Ramush Haradinaj thotë se AAK-ja nuk është pjesë e negociatave për formimin qeverisë së re

Haradinaj: Partia e parë e formon qeverinë



Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kjo parti nuk është pjesë e negociatave me ndonjë parti për formimin e qeverisë. Ai ka insistuar se i takon Vetëvendosjes si parti fituese t'i formojë institucionet e dala nga zgjedhjet e 6 tetorit. Në këtë kontekst, Haradinaj ka thënë se qeverinë ka të drejtë ta formojë vetëm Albin Kurti. "Nuk mundet i dyti ta formojë qeverinë. Qeverinë e formon i pari", ka thënë Haradinaj

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryeministri në detyrë dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka folur për negociatat e stërzgjatura që janë duke u zhvilluar në mes të Lëvizjes Vetëvendosjes dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës për bashkëqeverisje. Ai ka thënë se i takon Albin Kurtit si fitues i zgjedhjeve t'i krijojë institucionet e reja. I pyetur nga gazetarët nëse ka marrë ndonjë

ftesë nga Vetëvendosje apo LDK-ja për të diskutuar për formimin e qeverisë, Haradinaj ka thënë se deri më tani nuk ka marrë asnjë ftesë për një gjë të tillë. Haradinaj ka thënë se nuk ka ndonjë informacion se çfarë realisht është duke ndodhur në procesin negociator në mes të LV-së dhe LDK-së. "Sa i përket LDK-së dhe LV-së, të them të drejtën nuk na ka kontaktuar askush, prej Vetëvendosjes në radhë të parë. Nuk e dimë çka është duke ndodhur saktësisht. Dëgjojmë plot informata, por

nuk kemi qenë palë dhe nuk e dimë procesin. E kam thënë disa herë se në sistemin tonë parlamentar partia e parë e ka përgjegjësinë t'i krijojë institucionet. Unë e kam pasur fatin e mirë që të krijoj dy herë qeverinë, herën e dytë ka qenë para dy vjetësh dhe nuk ka qenë proces i lehtë, kam qenë i detyruar, ku ju dhe populli i Kosovës ende më kritikoni sot qoftë për numrin e zëvendësministrave, qoftë edhe për qeverinë e madhe. Kam qenë i sfiduar për të arritur një shumicë për t'i siguruar Kosovës

qeverisje", ka thënë Haradinaj të premtën pas mbledhjes së qeverisë.

Lideri i AAK-së ka thënë se nuk janë në pozitë që të kërkojnë takim me Vetëvendosjen dhe LDK-në për çështjen e qeverisë. "Tani mendoj se Kurti dhe Vetëvendosja janë përgjegjëse për t'ia dhënë Kosovës institucionet. Në rastin konkret ne nuk mund të kërkojmë takim me ta, as me Kurtin dhe as me LDK-në, sepse praktika është se ai i cili i ka fituar zgjedhjet e vlerëson se kë duhet ta thërrasë. AAK-ja nuk është pjesë e asnjë diskutimi apo të ndonjë negociate të çfarëdo natyre qoftë me Vetëvendosjen ose LDK-në", është shprehur Haradinaj. Më tutje, Haradinaj ka thënë se vetëm Lëvizja Vetëvendosje e ka mandatin qytetar që ta formojë qeverinë, pavarësisht se çfarë mendimi ka për liderin e

kësaj lëvizje, Albin Kurti. Ai ka thënë se partia e dytë nuk mund ta bëjë një gjë të tillë. "Nuk mundet i dyti ta formojë qeverinë. Qeverinë e formon i pari. E keni parasysh se vetëm i pari e formon qeverinë. Unë kur kam qenë në proces të formimit të qeverisë, pasi ia kemi dhënë një ministri një partie, atë të Bujqësisë, ka qenë kusht prej një partie tjetër dhe në çastet e fundit koalicioni ka qenë gati i prishur. Prandaj, e them se vetëm i pari e formon qeverinë, nuk mundet i dyti. Nuk ka lidhje se si e ka emrin i pari, ka mundur ta ketë Isa Mustafa ose LDK dhe ai do të ishte përgjigjur. Dhe nëse është Albin Kurti dhe Vetëvendosje fitues i zgjedhjeve, vetëm ai mund ta formojë qeverinë, përderisa nuk ka një situatë të re kur i pari konfirmohet se nuk mund ta bëjë qeverinë", ka thënë Haradinaj.

Qeveria ndan 250 mijë euro për koalicionin global për luftën kundër terrorizmit

PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, e drejtuar nga kryeministri Ramush Haradinaj, ka zhvilluar të premtën mbledhjen në të cilin ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për ta mbështetur koalicionin global në luftë kundër ISIS/DAESH. Me vendimin e miratuar janë ndarë mjete në

vlerë prej 250 mijë eurosh dhe këto mjete janë ndarë nga shpenzimet e paparashikuara. Vendimi obligon Ministrinë e Financave, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe institucionet e tjera kompetente për zbatim të vendimit. Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka theksuar se Kosova si anëtare e koalicionit global për luftimin e terrorizmit

është e përkushtuar ta mbështesë në të gjitha format luftën për demokraci dhe liri. "Kosova radhitet përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës në luftën kundër terrorizmit dhe për arritjen e objektivave të koalicionit global për luftimin e terrorizmit kudo në botë", ka thënë kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, në mbledhjen e qeverisë.





PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, I KA SHKRUAR LETËR LIDERIT TË LËVIZJES VETËVENDOSJE, ALBIN KURTI

PRESIDENTI I KËRKON VETËVENDOSJES MANDATARIN PËR FORMIMIN E QEVERISË

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ia ka kërkuar të premtën Lëvizjes Vetëvendosje (LV) emrin e kandidatit për kryeministër. Përmes një letre drejtuar liderit të LV-së, Albin Kurti, presidenti ka kërkuar që të njoftohet nëse Vetëvendosja do ta dorëzojë emrin e mandatarit për kryeministër apo do të refuzojë ta bëjë një gjë të tillë. Kjo e fundit nuk i është përgjigjur letrës së presidentit. Ndërsa njohësit e proceseve politike letrën e presidentit Thaçi e kanë parë si presion politik ndaj Kurtit për të arritur sa më shpejt marrëveshje me LDK-në

EPOKA E RE

Muhamet KOCI


PRISHTINË, 10 JANAR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një letre zyrtare i ka kërkuar kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurtit, emrin e mandatarit të Vetëvendosjes për postin e kryeministrit, për ta shmangur vonesën rreth formimit të qeverisë së re. Në letrën e tij presidenti ka vlerësuar se pas konstituimit të Kuvendit me të drejtë qytetarë e Kosovës presin që ai ta dekretojë kandidatit për kryeministër për formimin e qeverisë së re. "Si president i Republikës së Kosovës jam i obliguar që të ndërmar veprime pa vonesa të mëtejme, duke ndjekur të gjithë hapat kushtetues që qytetarët e Republikës së Kosovës ta kenë sa më shpejt qeverinë e tyre. Duke marrë parasysh parimet demokratike, transparencën dhe korrektësinë politike, ua kam dhënë mundësinë dhe kam kërkuar në vazhdimësi që ta propozoni kandidatit/en për kryeministër", ka shkruar Thaçi.

Aty përmendet edhe pika 87 e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, ku thuhet se nuk përjashtohet mundësia që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë ta marrë

mandatin. "Duke pasur parasysh edhe Pikën e 87 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. K0103/14, e cila vëren 'se nuk përjashtohet që partia ose koalicioni në fjalë do të refuzojë ta marrë mandatin'. Në cilindo rast, të pranimit ose refuzimit të propozimit të kandidatit/es për kryeministër, luteni që të më njoftoni sa më shpejt, sipas premtimit tuaj nga takimi ynë, në mënyrë që unë t'i ndërmarr të gjithë hapat e përcaktuar në Kushtetutë dhe ta dekretoj kandidatit/en për kryeministër për ta formuar Qeverinë e Republikës së Kosovës", është thënë në letrën e Thaçit.

Lëvizja Vetëvendosje dhe as lideri i saj, Albin Kurti, nuk i janë përgjigjur presidentit në këtë letër. Por, njohësit e rrethanave politike këtë letër të presidentit e kanë parë si presion politik që palët, LV-ja dhe LDK-ja, ta bëjnë më shpejt marrëveshjen për bashkëqeverisje.

Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë për gazetën "Epoka e re" se një letër e tillë nuk ka bazë kushtetuese. "Kjo letër nuk është kushtetuese. Është më tepër një presion politik në mënyrë që palët të arrijnë sa më shpejt marrëveshje për bashkëqeverisje dhe LV-ja ta paraqesë emrin e mandatarit. Mendoj se kjo nuk ka bazë



kushtetuese dhe presidenti e di mirë që nuk ka të drejtë ta bëjë një gjë të tillë. Mirëpo në aspektin politik këtë letër mund ta kuptojmë si presion politik,

sepse edhe presidenti është në mesin e atyre që po kërkon marrëveshje për formimin e qeverisë së re", ka thënë Mushkolaj. Sipas tij, LV-ja nuk do t'i

përgjigjet presidentit derisa të ketë ndonjë marrëveshje konkrete me LDK-në. "Dhe siç po shihet, deri më tani LV-ja nuk është e interesuar për t'iu përgjigjur, sepse ende nuk ka ndodhur diçka konkrete, në mënyrë që presidenti ta konsiderojë si një fillim i rrjedhjes së atij afatit kushtetues prej 15 ditësh", ka thënë ai.

Mushkolaj nuk beson se presidenti do ta mandatojë Kurtin për kryeministër pa një letër zyrtare nga LV-ja. "Deri më tani kjo nuk ka qenë një praktikë kushtetuese. Nuk është e ditur qartësisht nëse presidenti mund ta bëjë një veprim të tillë, mirëpo nëse presidenti e ndërmerret një hap të tillë, atëherë besoj se presioni do t'i hapte rrugë një interpretimi të Gjykatës Kushtetuese, gjë e cila do të na fuste në një zvarritje të re të procesit. Besoj se këtë e ka parasysh presidenti dhe jam i bindur që ai nuk ndërmerret diçka që do të shkonte në 'favor' të Vetëvendosjes, sepse Vetëvendosje ndoshta do të dëshironte që presidenti do të vëprente në këtë mënyrë", ka thënë Mushkolaj.

Por, ndryshe mendon analisti

tjetër politik Ramush Tahiri. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nëse nuk ka marrëveshje LV-LDK presidenti mund ta mandatojë Albin Kurtin për kryeministër edhe pa propozim formal të LV-së. Tahiri ka treguar se presidenti këtë mund ta bëjë duke u thirrur në konsultimin që ka pasur me të dhe në videomesazhin që Kurti ka publikuar në "Facebook", përmes të cilit ka treguar se është kandidat i LV-së për kryeministër dhe ka propozuar ministrat e subjektit të tij. "Mendoj se presidenti Hashim Thaçi duhet ta nominojë Albin Kurtin për kryeministër sepse Albin Kurti përmes videomesazhit të publikuar në profilin e vet në "Facebook" është deklaruar se është kandidat i LV-së për kryeministër. Në atë videomesazh ai ka thënë se si kandidat për kryeministër i LV-së i ka propozuar ata emra për ministra nga subjekti që drejton. Një veprim i tillë është pranim se është kandidat për kryeministër, pra me videomesazh dhe me shkrim ai deklarohet. Mendoj se tani Thaçi nuk ka nevojë të konsultohet se kush do të jetë kandidat për kryeministër nga LV-ja", ka thënë Tahiri.

LV-ja dhe LDK-ja ende pa marrëveshje

Gjatë të premtës nuk ka pasur ndonjë përpjekje të re të LV-së për t'u takuar dhe për të biseduar me zyrtarët e LDK-së për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje. Takimi i tretë i kësaj jave në mes të krerëve të LV-së dhe LDK-së ka përfunduar të enjten pa sukses. Një ditë pas takimit, nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Agim Veliu, ka thënë se, sipas mendimit të tij, nuk janë aq afër arritjes së marrëveshjes me LV-në. Ai ka deklaruar se LV-ja duhet t'i marrë përgjegjësitë që i ka. "Ajo e ka përgjegjësinë që t'i themelojë institucionet, të marrë hapa, sepse ajo ka dalë partia e parë. LDK-ja i ka humbur zgjedhjet dhe nuk është parti e parë, është parti e dytë. Edhe duke qenë në këtë situatë do të thotë jemi të detyruar t'i presim hapat e LV-së, sepse ajo është përgjegjëse për themelimin e institucioneve. Nuk kisha thënë që jemi aq afër marrëveshjes", ka thënë Veliu për "Klan Kosova". Kurse deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, duke folur për situatën aktuale rreth negociatave për formimin e qeverisë me LDK-në, ka thënë se interesimi i opinionit dhe vëmendja për çështjet që janë me interes të përgjithshëm është i natyrshëm dhe i pritshëm. "Pa marrë parasysh se cilat janë motivet e interesimit, është legjitime e drejta për të ditur. Por, nuk duhet harruar se shpeshherë ndalimi për të sqaruar gjithçka mund të na pengojë për ta arritur qëllimin final. Andaj dhe duhet durim e angazhim

për të arritur te caku. Në Kryesinë e LV-së i kemi deleguar detyrën e zhvillimit të bisedimeve grupit punues deri në gjetjen e zgjidhjes më të mirë për vendin, sipas vullnetit të shprehur nga qytetarët. Andaj dhe me besimin e plotë të kryetari Kurti dhe kolegët tanë ftoj për durim", ka shkruar Nagavci në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka theksuar se në momentet e rëndësishme, përkundër tensionit e presionit, e madje pikërisht për këtë, vendimet duhet të jenë të matura mirë, të kujdesshme e të drejta. "Dëshira për zgjidhje të shpejta e arritje të marrëveshjes, sado e kuptueshme, nuk mund të jetë arsyeja për ta humbur durimin. Rruga përpara është e gjatë, ka momente zhgënjimi e frike, por vendimet e drejta na sigurojnë që shpresa për zhvillim, angazhimi për drejtësi e kohët e bukura, të jenë më të afërta e të zgjasin më shumë", ka shkruar Nagavci. Presidenti Hashim Thaçi ka pritur në një takim Albin Kurtin ku është diskutuar për mandatarin për kryeministër. Më pas, Thaçi i kishte dhënë një afat prej 48 orëve Vetëvendosjes dhe Kurtit për ta propozuar mandatarin. Por, Vetëvendosje e cilësoi afatin e Thaçit si joligjor dhe paralajmëroi se do ta dërgonte emrin e mandatarit së shpejti, përmes një letrë. Caktimi i mandatarit dhe nominimi i tij nga presidenti ka efekte ligjore pasi që nga ai moment rrjedh edhe afati kushtetues prej 15 ditëve për formimin e Qeverisë së Kosovës.

Konjufca vlerëson lart mbështetjen e Sllovenisë për Kosovën



PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të premtën në takim ambasadoren e Sllovenisë në vendin tonë, Bojan Bertonec, me të cilin ka diskutuar për raportet e mira që të dy vendet kanë ndërtuar ndër vite. Ambasadori Bertonec i përcolli kryeparlamentarit Konjufca urimet e homologut të tij slloven, Dejan Zidan, me rastin e zgjedhjes në krye të Kuvendit të Kosovës.

Kryeparlamentari Konjufca ka vlerësuar lart mbështetjen e Sllovenisë për Kosovën në të gjitha proceset, ndërsa përkrah-

jen për Kuvendin e saj e ka konsideruar të një rëndësie të veçantë. Ai ka thënë se nëpërmjet kësaj mbështetjeje Kuvendi ka arritur t'i avancojë kapacitetet në shumë aspekte të punës së tij, ndërsa ka theksuar nevojën që bashkëpunimi midis dy parlamenteve të forcohet edhe më tej në të ardhmen. Kryetari i Senatit të Parlamentit të Republikës Çeke, Jaroslav Kubera, nëpërmjet një telegrami ka uruar kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, me rastin e zgjedhjes së tij në këtë detyrë. "Shkëlqesia juaj, më lejoni t'ju përgëzoj me rastin e zgjedhjes tuaj në postin

e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, personalisht, si dhe në emër të të gjithë anëtarëve të Senatit të Parlamentit të Republikës Çeke. Më lejoni t'ju uroj shumë sukses gjatë kryerjes së këtij funksioni të rëndësishëm. Unë besoj se marrëdhëniet midis organeve tona ligjvënës do të vazhdojnë të zhvillohen në frymë miqësore në të ardhmen. Ju lutem, Shkëlqesia juaj, pranoni konsideratën time më të lartë për ju, si dhe urimet më të mira për një Vit të Ri të suksesshëm", është thënë në telegramin e urimit të kryesëtorit çek Jaroslav Kubera.

Më 13 janar fillon gjysmëvjetori i dytë



**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 JANAR - Më 13 janar do të rinisë mësimi në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës. Këshilli Drejtues, kryetarët e nivelit sindikal komunal dhe të universiteteve, bashkë me kryesinë e SBASHK-ut, kanë uruar që sa më parë ta fillojnë punën institucionet e dala nga vota e 6 tetorit dhe të rinisë dialogu për shumë çështje në arsim. "SBASHK-u vepron në bazë të zërit të punëtorëve në tërë arsimin e Kosovës dhe sa herë që

anëtarësia vlerëson se dialogu nuk po jep rezultate të duhura, atëherë fillohet me veprime sindikale. Pasi që këtyre ditëve në selinë e SBASHK-ut kemi marrë shumë telefonata nga individë, por edhe nga disa medie të nderuara e që kanë të bëjnë me gjysmëvjetorin e dytë, për t'i hequr shqetësimet e prindërve dhe për t'ua pamundësuar individëve të caktuar, që me apo pa dashje të shpërndajnë dezinformata, SBASHK-u u drejtohet të punësuarve në arsimin parauniversitar dhe nxënësve të nderuar me urimin për rifillim të mbarë

të betejës për dije të reja. Pra, më 13 janar do të rinisë mësimi në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës dhe SBASHK-u pret që të përmbillet në tërësi aktiviteti i nisur nga anëtarësia për mbledhjen e nënshkrimeve dhe dërgimin e kërkesave në Qeverinë e Kosovës dhe tek institucioni i Avokatit të Popullit, me kërkesën që ata t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për revokimin e vendimit të masës së përkohshme për pezullimin e Ligjit të pagave", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

Raportet e shkëlqyera Kosovë - Gjermani të shfrytëzohen edhe më shumë në rritjen e bashkëpunimit

PRISHTINË, 10 DHJETOR (ER) - Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Rejhan Vuniqi, ka prituri në takim Susanne Schutz, drejtoreshë për Evropën Jug-Lindore, Turqi dhe shtetet anëtare të Asociacionit Evropian për Tregti të Lirë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Gjermanisë.

Në këtë takim, në të cilin ishte i pranishëm edhe ambasadori gjerman në Prishtinë, Christian Held, është biseduar për zhvillimet politike në Kosovë, përfshirë sfidat në krijimin e institucioneve të reja pas zgjedhjeve parlamentare të tetorit të vitit të kaluar. Zëvendësministrja Vuniqi dhe diplomatja Schutz

gjatë këtij takimi kanë biseduar edhe për zhvillimet politike në rajon, për proceset e fqinjësisë së mirë dhe ato të integritit të Kosovës dhe rajonit në strukturat evropiane.

Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme ka falënderuar Schutz për angazhimin e saj dhe mbështetjen e vazhdueshme dhe shumë të çmuar që Gjermania vazhdon të japë për shtetin e Kosovës. "Raportet e shkëlqyeshme bilaterale midis Kosovës dhe Gjermanisë duhet të shfrytëzohen edhe më shumë për rritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë në të gjitha fushat me interes për popujt e të dyja vendeve", ka thënë Vuniqi.



Gjykata Themelore Gjilan ka zgjidhur 13 605 lëndë

GJILAN, 10 JANAR (ER) - Gjykata Themelore në Gjilan ka përmbyllur vitin 2019, duke zgjidhur më shumë lëndë nga ato që ka pranuar, që nënkupton se numri i lëndëve në çdo vit është duke rënë. Këto të dhëna janë bërë të ditura në konferencë për media të mbajtur nga kryetari i Gjykatës, Ramiz Azizi, i cili ka folur edhe për sfidat që e kanë përcjellë, si dhe planet për vitin 2020.

Në bazë të statistikave, lëndë të trashëguara në vitin 2019 kanë qenë 17 355, janë pranuar 12 012 lëndë (gjithsejtë 29 367 lëndë), gjatë vitit është arritur të zgjidhen 13 605 lëndë, ndërkohë janë bartur në vitin 2020 edhe 15 762 lëndë, përqindja e numrit të lëndëve



të zgjidhura është 113 për qind. Sa iu përket lëndëve të natyrës së korrupsionit, Azizi ka theksuar se janë trashëguar 20

lëndë të korrupsionit, ndërkohë janë pranuar 22 lëndë të kësaj natyre (gjithsejtë 42 lëndë), prej tyre janë zgjidhur

22 lëndë, kanë mbetur në punë edhe 20 lëndë. "Ky numër është rënë në mënyrë drastike, ngase vetëm para 2-3 vjetëve numrin e lëndëve të kësaj natyre e kemi pasur mbi 40 lëndë, ndërkohë tash kemi 20 lëndë në vitin 2020. Gjyqtarët kanë shqiptuar sanksione për këto lëndë, gjashtë aktgjykime me burgim, dy aktgjykime dënim me gjobë, dy aktgjykime dënim me kusht, nëntë aktgjykime lirues dhe tri aktgjykime refuzuese. Këto lëndë vazhdojnë të kenë prioritet nga gjykata jonë edhe më tutje", ka theksuar Azizi.

Gjykata Themelore e Gjilanit së bashku me degët, për vitin 2019, ka shqiptuar këto sanksione penale ndaj kryerësve të

veprave penale të të gjitha llojeve: 278 aktgjykime dënime me burgim, 722 aktgjykime dënime me kusht, 80 aktgjykime lirues, 98 aktgjykime refuzuese dhe 817 lëndë janë zgjidhur në mënyrë tjetër.

I pari i Gjykatës ka thënë se kjo tregon që jemi të pakompromis ndaj kryerësve të veprave penale, të të gjitha llojeve, pa dallim, duke shtuar se prioritet i është dhënë edhe zgjidhjes së lëndëve të dhunës në familje, krimin të organizuar, lëndëve me narkotikë dhe grabitjeve. Për më tepër ai ka shtuar se gjatë vitit 2019 problemin më të madh Gjykata e ka pasur me mungesën e përkthyesve të gjuhës serbe.

Shoqata 'Bereqeti' vazhdon t'i ndihmojë familjet në nevojë

PRIZREN, 10 JANAR (ER) - Shoqata Humanitare "Bereqeti", organ i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, edhe në këto ditë të ftohta dimri vazhdon të jetë në krahë dhe ndihmë familjeve në nevojë. Dega e "Bereqetit" në Prizren ka njoftuar se janë duke bërë furnizimin e familjeve në nevojë me veshmbathje edhe gjatë këtij sezoni dimëror.

Kurtish ef. Hoxhaj, koordinator i "Bereqetit" në Degën e Prizrenit, ka thënë se nevojat janë më të mëdha se mundësitë e tyre, por janë duke u munduar që t'u dalin në ndihmë familjeve më me nevojë gjatë këtyre ditëve të ftohta dimri. "Vetëm gjatë këtyre ditëve kemi ndihmuar 13 familje

me veshmbathje, jorganë dhe artikuj ushqimorë", ka bërë me dije Hoxhaj.

Ai ka falënderuar donatorët nga vendi dhe diaspora të cilët kanë ndihmuar dhe përkrahur aktivitetet e "Bereqetit" në Prizren të cilët janë të shumtë. "Gjatë aktivitetit të vitit të kaluar 'Bereqeti' në këtë komunë ka ndihmuar më se 3 000 familje me gjëra ushqimore, veshmbathje, pako higjienike e gjëra të tjera të nevojshme dhe ka rregulluar dhe lyer katër shtëpi. Krahas këtyre ndihmave ka furnizuar mbi 50 familje me dru për ngrohje, shporet, stufa, frigorifer, për t'ua sadopak lehtësuar jetën familjeve me nevojë që t'i përballojnë

këto ditë të ftohta dimri. Mbi 1 500 fëmijë ka arritur t'i gëzojë me dhurata e lodra për festa dhe janë 450 nxënës të cilët kanë përfituar çanta dhe pajisje të tjera shkollore. Po ashtu, gjatë vitit që sapo lamë pas 'Bereqeti', Dega në Prizren, ka vizituar mbi 20 institucione publike si shkolla, shoqata, OJQ, duke ofruar ndihmën dhe përkrahjen e saj", ka treguar Hoxhaj.

Shoqata Humanitare Bamirëse "Bereqeti" po ashtu ka njoftuar se të gjitha familjet të cilat kanë nevojë për veshmbathje që të lajmërohen në zyrën e Shoqatës Humanitare "Bereqeti" e cila gjendet në rr. "Fatmir Berisha" (te Xhamia e Re, afër tregut në



lagjen Bajram Curri). "Bereqeti", po ashtu, ka premtuar se do t'i ndihmojë familjet që kanë nevojë edhe gjatë këtij viti dhe fton

bamirësit dhe donatorët ta shtrijnë dorën që edhe shtresa tjetër e shoqërisë të ketë kushte dhe jetë të dinjitetshme.

Për krizën Shqipëri - Iran: As panik, as eufori, por më shumë vigjilencë dhe siguri



Prof. Lisen BASHKURTI

Viti 2020 filloi me një krizë komplekse midis ShBA-së dhe Iranit në qendër të Lindjes së Mesme. Politika, opinioni publik dhe media shqiptare e kanë ndjekur gjithë këtë teatër krize në Lindjen e Mesme me interes të lartë. Politika shqiptare në unison mbështeti veprimet, qëndrimet dhe deklaratimet e ShBA-së në Lindjen e Mesme dhe në qasjet ndaj Iranit. Gjithashtu, politika shqiptare njëzëri ka qenë kritike për regjimin e Iranit dhe politikën e tij në Lindjen e Mesme si dhe ka dënuar veprimtarinë e gjeneral Suljemanit, si terrorist i rrezikshmërisë së lartë ndërkombëtare dhe që, për këtë arsye, ekzekutimi i tij ka qenë i drejtë dhe i dobishëm në mbrojtje të interesave të ShBA-së si dhe të paqes dhe sigurisë në rajon.

Ndërkohë, në politikën shqiptare, në opinionin publik dhe në media ka pasur qasje të ndryshme, herë-herë edhe kontradiktore lidhur me krizën ShBA - Iran. Pjesa më rëndësishme e këtij debati publik e mediatik është bërë rreth qasjes së Shqipërisë lidhur me konfliktin ShBA - Iran dhe përfshirjen e saj në të, si dhe për shkallën e kërcënimit që mund të sjellë ky qëndrim dhe kjo përfshirje për sigurinë e vendit.

Ndërkohë, ajo që bie në sy është deklarimi i kreut të Qeverisë Shqiptare, Rama, nga Vjena, sipas së cilës, "Shqipëria nuk është e kërcënuar nga Irani, sepse është e mbrojtur nga NATO". Mendoj se një deklaratë e tillë e kreut të Qeverisë, Rama, nuk pasqyron qartësisht situatën e krizës ShBA - Iran në Lindjen e Mesme, përfshirjen e Shqipërisë në të, kushtet specifike të Ballkanit dhe të vendit tonë në aspektin e sigurisë si dhe kërcënimet që rrjedhin prej saj. Deklarata e kreut të Qeverisë, z. Rama, e cila mund të jetë nisur nga dëshira për të mënjeluar panikun, në fakt është e ngarkuar me eufori, që nuk adreson sa dhe si duhet situatën e krizës ShBA - Iran, përfshirjen e Shqipërisë në të, si dhe specifikat e Ballkanit dhe vendit tonë si dhe kërcënimet e sigurisë kombëtare.

1. Gadishulli Ballkanik i kërcënuar nga kriza

Gadishulli Ballkanik nuk është larg zonës së krizës në Lindjen e Mesme. Gjeografikisht, Ballkani konsiderohet hapësirë e ekspozuar së tepërmi nga kërcënimet e sigurisë.

Në tri anët e tij, Jug, Lindje dhe Perëndim, Ballkani laget nga dete të cilët përbëjnë rrugë me kalime të pakufizuara, për prosperitet në raste paqeje, por edhe për kërcënime në raste krizash, konfliktesh dhe luftërash.

Krizat e fundit, në Ukrainë, në Lindjen e Mesme, në vendet e Magrebit kanë goditur direkt Gadishullin Ballkanik. Gadishulli është shndërruar një nga tri rrugë-kalimet e valëve emigrative, refugjatëve të zonave të krizave, trafiqeve të paligjshme, kontrabandave dhe krimin të organizuar. Ngushtica e Gjibraltarit, ishulli Lampeduza dhe Gadishulli i Ballkanit kanë qenë dhe mbeten tre korridoret e transferimit të krizave nga Lindja e Mesme dhe Magrebi drejt Kontinentit Evropian.

Në mënyrë të veçantë, Shqipëria, si një vend kufiri i së cilës laget në më të shumtën e tij nga detet Adriatik dhe Jon, është veçanërisht e kërcënuar nga krizat e Lindjes së Mesme dhe të Magrebit. Strukturat e sigurisë mbrojtëse në tokë, në det dhe në ajër të Ballkanit përgjithësisht dhe të Shqipërisë veçanërisht, janë të pamjaftueshme për të përballuar këtë fluks krizash në hapësirat tona sovraane. Prandaj, çdo ngritje tensioni, çdo përshkallëzim konflikti dhe aq më shumë çdo përplasje e armatosur në Lindjen e Mesme dhe në Magreb, në mënyrë të pashmangshme kërcënojnë sigurinë në Ballkan dhe në Shqipëri.

2. NATO, mbrojtje kolektive dhe kontribut individual

Në deklaratën e mësipërme kryeministri Rama shpreh se Shqipëria është e mbrojtur nga NATO. Kjo është e vërtetë. Si anëtare e NATO-s Shqipëria përfton siguri e mbrojtje nga NATO, bazuar në Artikullin 5 të Traktatit të Organizatës për mbrojtjen kolektive. Por, ama, është po aq e vërtetë se koncepti i mbrojtjes kolektive të NATO-s definohet si bashkim rolesh dhe kontributesh individuale, si bashkim investimi dhe prodhimi në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes të çdo vendi anëtar.

Të konceptuarit e mbrojtjes kolektive të NATO-s, si një ekskludim të përgjegjësive dhe rolit të çdo vendi anëtar, për të investuar dhe prodhuar siguri dhe mbrojtje individuale, është konceptim jo i saktë. Koncepti i NATO-s për mbrojtjen kolektive ngrihet mbi tërësinë e rolit dhe kontributit të shteteve individuale. Sa më shumë rol, investim e prodhim sigurie e mbrojtje të kenë shtetet individuale, aq më e fuqishme bëhet mbrojtja kolektive e NATO-s. Qasja e kundërt do ta dobësonte NATO-n dhe do të krijonte vrima pasigurie në hapësirën Euro-Atlantike.

Koncepti i NATO-s për mbrojtje kolektive nuk është transferim përgjegjësie nga shtetet anëtare te strukturat e Aleancës, por është përgjegjësi përfshirjeje e çdo shteti anëtar, me rol, kontribut dhe investim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Pikërisht, këtë koncept ka lansuar së tepërmi vitet e fundit presidenti Trump mbi vendin dhe rolin e NATO-s. Ai vazhdimisht ka theksuar që NATO mund t'i adresojë krizat bashkëkohore dhe t'i shërbejë të ardhmes së paqes e sigurisë në hapësirën Euro-Atlantike vetëm nëse çdo shtet anëtar rritë rolin dhe kontributin e vet individual në strukturat e sigurisë kolektive të Organizatës. Presidenti Trump ka apeluar që çdo shtet anëtar duhet t'i paguajë kontributet për Organizatën. Madje, ai ka theksuar se mbështetja e Aleancës për shtetet individuale do të jetë proporcionalisht me kontributin e tyre individual në organizatë. Në mënyrë specifike, mbas krizës ShBA - Irak të këtij fillim viti, presidenti Trump ka apeluar për një përfshirje më të madhe të NATO-s, çka do thotë edhe shteteve individuale të saj, në krizën e Lindjes së Mesme.

Apeli i presidentit Trump, që çdo vend anëtar i NATO-s t'i paguajë kontributet financiare për Organizatën, nga njëra anë, dhe thirrja e ditëve të fundit që NATO të përfshihet më shumë në krizën e Lindjes së Mesme, duhet të dëgjohet me kujdes nga çdo shtet anëtar i organizatës dhe nga Shqipëria veçanërisht.

3. Shqipëria në krizë me Iranin

Kur them se apeli i presidentit duhet dëgjuar me kujdes nga Shqipëria veçanërisht, kam parasysh se specifikisht marrëdhëniet e Shqipërisë me Iranin janë në gjendje krize. Marrëdhëniet politike janë tërësisht të ngrira. Marrëdhëniet diplomatike janë në nivelin më të ulët. Marrëdhëniet ekonomike e tregtare as që llogariten. Ndërkohë, marrëdhëniet kulturore, arsimore e shkencore janë thuajse në rrafshin zero.

Pikun kriza bilaterale diplomatike Shqipëri - Iran e arriti vitin e kaluar. Le të kujtojmë se në vitin 2019, për shkaqe veprimtarie konspirative e kërcënuese të Ambasadës së Iranit në Shqipëri, qeveria e shpalli 'non grata' ambasadorin iranian, duke e përzënë nga vendi. Përzënia e ambasadorit është një nga treguesit më të lartë të krizës në marrëdhëniet midis dy vendeve. Për këtë situatë krize, prej kohësh diplomacia Iraniane është përpjekur të fajësojë faktorë dhe palë të treta, midis Iranit dhe Shqipërisë. Kështu në shkurt të vitit të kaluar, 2019, kreu i misionit të Iranit në Shqipëri, Amir Ali

Taghikhani, deklaroi me një gjuhë të kamufluar diplomatike, se "Shqipëria është një vend i rëndësishëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Republika Islamike e Iranit e kupton më së miri dhe qartazi këtë rëndësi. Megjithatë, faktorë dhe palë të treta janë duke influencuar negativisht në marrëdhëniet midis tyre...".

Cilët janë faktorët dhe palët e treta që, sipas diplomacisë iraniane, po influencojnë negativisht në marrëdhëniet midis tyre? Qartësimin e kësaj pyetjeje na e bëri ditët e fundit lideri suprem i Iranit, Khamenei, në adresimin pas varrimit të gjeneral Suljemanit dhe goditjes kundërvepruese kundër ShBA në Irak.

Aktualisht, niveli i krizës Shqipëri -Iran ka hyrë në fazë të re. Fakti i deklaratimit të liderit suprem, Khamenei kundër Shqipërisë, e ngre në shkallë më të lartë kërcënimin për Shqipërinë. Kryefjala e fjalimit të Khameneit ishin akuzat dhe paralajmërimet ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por në të njëjtën kohë edhe ndaj shteteve të tjera aleate të saj. Ali Khamenei, në nëntekst e konsideroi Shqipërinë një prej këtyre shteteve pro amerikane. Për herë të parë lideri suprem iranian foli me nënkuptim, por qartazi për Shqipërinë. Ndonëse nuk e përmendi me emër, Shqipërinë, aludimet ishin shumë të kuptueshme. Ai tha se "Një vend i vogël evropian, shumë i vogël dhe djallëzor, ka bërë komplot me ShBA-në dhe tradhtarët e MEK kundër Iranit".

Pra, dy janë shkaqet që identifikojnë njëkohësisht edhe 'palët e treta', sipas Khameneit, që Shqipëria renditet në shtete armike që komploton kundër Iranit: së pari, është aleanca e fortë ShBA - Shqipëri dhe; së dyti, ekzistenca e muxhahidinëve të MEK në Shqipëri, të cilët punojnë ndërkombëtarisht kundër regjimit aktual autokrat dhe teokratik Iranian. Khamenei e përfshiu Shqipërinë në rrathë të dyfishtë armiqësie me Iranin. Shqipëria konsiderohet si komplotuese me ShBA-në kundër interesave të Iranit. Dhe jo vetëm kaq, por Shqipëria konsiderohet edhe si vend komplotues me MEK kundër regjimit politik të këtij vendi, duke strehuar dhe mbështetur opozitën politike iraniane në Shqipëri. Pra, Khamenei e konsideron publikisht Shqipërinë shtet armiqësor kundër shtetit të Iranit dhe kundër regjimit politik të tij.

Ky vlerësim në rrathë të dyfishtë të Shqipërisë nga Irani, deri kohë më parë, ka qenë i rezervuar nga bërja publike kombëtare dhe ndërkombëtare. Pozicionimi armiqësor i Iranit kundër Shqipërisë përbën kërcënim maksimal për Shqipërinë, shtetin dhe qytetarët shqiptarë kudo në

botë.

Realisht dhe potencialisht, Irani ka drejtpërdrejt agresivisht si shtet por, edhe tërthorazi si rrjet terrorist rajonal e më gjerë. Dekoratat armiqësore të Khameneit kundër Shqipërisë, të bëra publike për herë të parë, përbëjnë kërcënim real për Shqipërinë dhe shqiptarët. Për momentin më të rrezikuara janë trupat shqiptare që veprojnë në kuadër të forcave ndërkombëtare kundër terrorizmit, në Irak dhe në Afganistan. Deklaratat e Khameneit mund të mobilizojnë forca shtetërore iraniane ose struktura të caktuara terroriste, paramilitare, grupe fanatikësh radikale, elementë xhihadistë, radikalë shiitë në Irak, Afganistan, në rajon, por nuk përjashtohen mundësitë edhe në Ballkan dhe në Shqipëri. Irani është potencialisht vend agresor por, mbi të gjitha, për kushtet specifike, më shumë sesa në nivel shtetëror, angazhimi i tij kërcënues është më i mundshëm përmes strukturave terroriste të shpërndara në një hapësirë të gjerë rajonale.

4. Fushat e kërcënimit iranian për Shqipërinë

Situatën e sigurisë së Shqipërisë përballë Iranit e kanë pasur në fokus të analizave edhe shumë ekspertët të lartë të sigurisë. Pra, nuk ka fare vend për eufori. Ekspertët e sigurisë të ShBA-së kanë bërë me dije se Shqipëria është në rrathët e kërcënimit iranian.

Gjenerali amerikan Michael Barbero, në një intervistë të ditëve të fundit, duke folur për Shqipërinë dhe krizën me Iranin, ka theksuar se për fat të keq Shqipëria konsiderohet si një shënjestër e Iranit. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve në një takim në Tiranë për sfidat e sigurisë, gjenerali Barbero deklaroi se fatkeqësisht çdo mik i ShBA-së apo aleat i tyre mund të shikohet si një shënjestër. Shqipëria nuk bën përjashtim. Ai tërhoqi vëmendjen që vigjilencë të jetë e lartë, veçanërisht në përpjekjet kundër terrorizmit dhe në fushën kibernetike, pasi Irani ka disa aftësi mjaft të sofistikuara për sulmet kibernetike.

Pra, në këto dy fusha terrorizmi dhe kibernetika janë potencialisht kërcënuese për Shqipërinë nga Irani. Ky fakt nuk lëkund dhe as nuk vë në dyshim aleancën strategjike Shqipëri - ShBA, por Shqipëria, përballë kësaj situatë të re sigurie, duhet të mendojë më racionalisht dhe të marrë masa dhe veprime më aktive, me qëllim që aleancën strategjike Shqipëri - ShBA ta konsiderojë dy dimensione, në përfitimet dhe në koston e saj. Çdo vështrim i njëanshëm nuk i shërben as Shqipërisë, as ShBA-së dhe aq më pak aleancës strategjike midis tyre.

Gërxhaliu: 'Trepça' duhet të mbështetet me investime të reja teknologjike



PRISHTINË, 10 JANAR - Eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, ka deklaruar se "Trepçës" i duhet mbështetje konkrete dhe jo vetëm me ligj. "Rëndësia e 'Trepçës' në shumë dimensione është e pakontestuar, në veçanti në atë ekonomik. Duhet kuptuar se sa i duhet Kosova sot 'Trepçës' ajo do t'i duhet Kosovës në të ardhmen", u shpreh Gërxhaliu. Sipas tij, s'mjafton vetëm ndryshimi ligjor lidhur me "Trepçën" si populizëm politik por, sipas Gërxhaliut, asaj i duhet ndihmë konkrete e cila do t'i ndihmojë në rivitalizimin e saj dhe rritjen e kapaciteteve prodhuese. Gërxhaliu ka theksuar se "Trepça" duhet të mbështetet me investime të reja teknologjike. "Me trajnime dhe rifreskim të stafit, me

teknologji të përpunimit të metaleve, për t'i shtuar vlerën, në veçanti të analizohet mundësia e partneritetit publiko-privat ku, përveç qeverisë, punëtorëve, edhe kapitali privat do të ketë mundësi të investojë në rivitalizimin e 'Trepçës', por gjithmonë bazuar në dialog, partneritet, në veçanti bazuar në sundim të rendit dhe ligjit", ka thënë ai. Gërxhaliu ka thënë se në fokus të qeverisjes së ardhshme duhet të jetë dhe rimëkëmbja e "Trepçës". "Nuk mjafton vetëm një ligj apo dokument për këtë ndërmarrje. Vetë fakti që 'Trepça' është barrë e qeverisë, është mjerim i madh. Duhet vërtet të punohet dhe të mendohet më e mira për të", u shpreh Gërxhaliu për gazetën "Epoka e re". (A. MAVRAJ)

Murtezaj priti në takim shefen e Njesisë për Ekonomi të Ambasadës së ShBA-së



PRISHTINË, 10 JANAR (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka pritur të premten në takim shefen e Njesisë për Ekonomi të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Lori Michaelson. Në këtë takim, drejtori Murtezaj ka

njoftuar Michaelson për zhvillimet dhe aktivitetet e ATK-së si dhe prioritetet për të ardhmen. Po ashtu, në takim u diskutua edhe për disa reforma që janë në proces të implementimit në administratën tatimore, të cilat mund të jenë fusha potenciale të

përkrahjes nga Ambada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Nga ana tjetër, Michaelson ka potencuar se janë të interesuar të kontribuojnë në aspektin e krijimit të institucioneve të vetëqëndrueshme në Kosovë.

Kapen rreth 600 litra pije alkoolike të kontrabanduara

PRISHTINË 10 JANAR (ER) - Njësitë e Doganës në fshatin Uglare të Komunës së Fushë-Kosovës kanë kapur rreth 600 litra pije alkoolike të cilat dyshohet se janë të kontrabanduara nga Serbia. "Gjatë patrullimeve rutinore njësitë e Doganës kanë hasur në produkte që kishin kërkuar dokumentacionin e importit, të cilin personi kompetent nuk ka arritur ta prezant-

tojë. Oficerët doganorë kanë ushtruar kontroll në shitore dhe depon e tij ngjitur me shitoren. Gjatë kontrollit të hapësirave të ndryshme të lokalit janë gjetur sasi të konsiderueshme të pijeve alkoolike. Pas kontrollimit janë gjetur rreth 600 litra pije alkoolike. Malli në fjalë është ndaluar përkohësisht dhe rasti ka vazhduar në procedurë të rregullt", është bërë me dije në njoftimin e Doganës së Kosovës.



Mosmiratimi i buxhetit vë në hall bizneset



PRISHTINË, 10 JANAR - Asnjë projekt i ri kapital nuk mund të fillojë së zbatuari për shkak të mungesës së miratimit të buxhetit për vitin 2020, thonë zyrtarë të Qeverisë në largim të Kosovës. Kosova ka hyrë në vitin 2020 pa buxhet të miratuar për shkak të mungesës së formimit të qeverisë së re, pas zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit, nga i cili proces deri më tani është konstituuar vetëm Kuvendi i Kosovës.

Përfaqësues të bizneseve në Kosovë bëjnë thirrje që të mos krijohen vonesa në miratimin e buxhetit për vitin 2020, pasi bizneset janë ato të cilat, sipas tyre, po dëmtohen më së shumti.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se janë projektet e planifikuara nga bizneset dhe disa të tjera tashmë të mbetura gjysmë, që po dëmtohen për shkak të mungesës së miratimit të buxhetit për këtë vit. "Ndikimet janë në masë të madhe negative jo vetëm për shkak të mosmiratimit të buxhetit, pasi që edhe të gjitha vonesat për krijimin e institucioneve janë shumë shqetësuese për klimën e të bërit biznes në vend", thotë

"Ndikimet janë në masë të madhe negative jo vetëm për shkak të mosmiratimit të buxhetit, pasi që edhe të gjitha vonesat për krijimin e institucioneve janë shumë shqetësuese për klimën e të bërit biznes në vend"

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës,
Berat RUKIQI

"Nëse zgjatja e përcaktuar me ligj për dy muajt e parë ose sipas një vendimi të kuvendit për tre muaj skadon dhe Ligji i ri për ndarjet buxhetore nuk është i martuar, atëherë asnjë organizatë buxhetore ose autoritet tjetër publik nuk mund të autorizojë asnjë shpenzim apo pagesë derisa të miratohet Ligji i ri për ndarjet buxhetore. Këtu nuk hyjnë pagesat për larjen e borxhit publik"

Zëdhënësi i Ministrisë së Financave,
Muharrem SHAHINI

Rukiqi. Muharrem Shahini, zëdhënësi në Ministrinë e Financave, tha për "Radion Evropa e Lirë" se buxheti për vitin fiskal 2020 vazhdon të zbatohet për dy muaj (janar, shkurt), duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Sipas tij, në rast të mosaprovimit të Ligjit për bux-

hetin e vitit 2020, vetëm Kuvendi me anë të një vendimi mund ta autorizojë zgjatjen (vazhdimësinë) e Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar që i përket 1/12 e vitit të kaluar për këtë vit fiskal. "Nëse zgjatja e përcaktuar me ligj për dy muajt e parë ose sipas një vendimi të kuvendit për tre muaj skadon dhe Ligji i ri për

ndarjet buxhetore nuk është i martuar, atëherë asnjë organizatë buxhetore ose autoritet tjetër publik nuk mund të autorizojë asnjë shpenzim apo pagesë derisa të miratohet Ligji i ri për ndarjet buxhetore. Këtu nuk hyjnë pagesat për larjen e borxhit publik", thotë Shahini. Ligji për ndarjet buxhetore i vitit të kaluar fiskal, në asnjë rast, sipas zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, nuk mund të vazhdojë të zbatohet për më gjatë se tre muaj të vitit të ardhshëm fiskal. Viti fiskal do të thotë perioda prej 1 janarit të një viti të caktuar deri më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Dëmtimin e bizneseve nga mosmiratimi i buxhetit e theksojnë edhe zyrtarë të Qeverisë në detyrë të Kosovës. "Nga mosmiratimi i buxhetit dëmtohen bizneset pasi që kemi të bëjmë me qarkullimin e parasë, janë projekte të ndryshme nëpër shkollat që nuk mund të realizohen por, mbi të gjitha, janë qytetarët e Kosovës që dëmtohen nga kjo", thotë Muharrem Shahini, zëdhënësi në Ministrinë e Financave. Agnesa Haxhiu, monitoruese e punës së Kuvendit të Kosovës nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), tha për "Radion

Evropa e Lirë" se mosmiratimi i buxhetit për 2020 po dëmton qytetarët. "Të gjitha projektet kapitale që kanë qenë të parapara të zhvillohen nuk mund të fillojnë pa një ligj të ri. Nëse vijmë në situatën kur edhe deri në fund të muajit mars nuk kemi një ligj të ri për ndarje buxhetore të këtij viti, atëherë nënkupton që asnjë organizatë buxhetore nuk mund të bëjë shpenzime dhe nënkupton që institucionet publike nuk mund të kryejnë asnjë funksion, pasi nuk ka buxhet dhe ata që dëmtohen më së shumti në këtë rast janë qytetarët e Kosovës", thotë Haxhiu.

Haxhiu shton se pas dy muajve të parë të këtij viti, në rast të mungesës së një vendimi nga ana e kuvendit për zgjatje edhe për një muaj, do ta bënte më pas të kundërligjshme çdo pagesë dhe shpenzim nga çdo organizatë buxhetore.

Qeveria në detyrë ka miratuar vetëm kornizën afatmesme të shpenzimeve, dokument ky mbi bazën e të cilit do të duhej të hartohej buxheti vjetor për vitin 2020. Buxheti i Kosovës për vitin 2020, sipas kornizës afatmesme, parashihet të jetë rreth 2.4 miliardë euro apo 1 milion euro më shumë sesa buxheti i vitit 2019.

PDK-ja në Prizren kritikon Haskukën për mungesë të transparencës

PRIZREN, 10 JANAR (ER) - Dega e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK) në Prizren ka vlerësuar se kryetari i kësaj komune, i cili vjen nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Mytaher Haskuka, ka mungesë të transparencës në punën e tij. "Një ndër indikatorët më të rëndësishëm të performancës për çdo lloj aktiviteti, përfshirë këtu edhe qeverisjen lokale dhe kryetarin e komunës, z. Mytaher Haskuka, është edhe transparenca. Mungesa e transparencës do të thotë mungesë e informacionit, lidhur me atë se çka po ndodh në këtë rast në pushtetin lokal në Prizren. Dhe kur ka mungesë informacioni, është e natyrshme të ketë rënie të besimit në qeverisjen lokale, e cila kishte premtuar shumë por, tekefundit, fare pa premtuar, transparenca është edhe obligim ndaj qytetarëve dhe opinionit publik", është thënë në reagimin e Degës së PDK-së në Prizren. Sipas kësaj dege, niveli i transparencës është matur nga shoqëria civile dhe është bazuar në disa shtylla vlerësuese, duke përfshirë transparencën në zyrën e kryetarit, Kuvendin Komunal, financat komunale si dhe transparencën në konsultim me publikun. "Vlen të përkujtohet se kryetari në

fushatë ka proklamuar konceptin 'transparencë radikale' nga i cili jemi shumë larg", është thënë në këtë reagim të Degës së PDK-së në Prizren.

Më tutje, në këtë reagim PDK-ja ka prezantuar edhe disa argumente të cilat, sipas tyre, dëshmojnë mostransparencën e kryetarit Haskuka. "Në fillim të qeverisjes nga ky pushtet, mbledhjet e bordit të drejtorëve kanë qenë të mbyllura për publikun dhe për këtë ka pasur reagime edhe nga rrjeti i OJQ-ve, medieve dhe organizatat që i përcjellin mbledhjet e bordit të drejtorëve. Kurse tani fare nuk mbahen mbledhjet e bordit të drejtorëve, që tregojnë se z. Haskuka nuk është transparent as ndaj bashkëpunëtorëve të afërm. Seancat e Kuvendit Komunal ka kohë që nuk transmetohen fare për opinionin publik. Qasja në dokumentet zyrtare, e cila është e rregulluar me ligj, ku pas çdo kërkesë, në një afat prej 7 ditësh, duhet të ketë një përgjigje, ka shumë raste kur qytetarëve u është refuzuar qasja në dokumentet zyrtare, edhe pse ligji ua garanton një të drejtë të tillë", është thënë në këtë reagim.

Po ashtu, Dega e PDK-së në Prizren ka përmendur edhe punësimet në Drejtorinë e



Arsimit dhe në atë të Shëndetësisë, të cilat, sipas kësaj dege që drejtohet nga Shaqir Totaj, janë misterioze. "Flitet që mbi 5 milionë euro janë suficit

nga viti 2019 mirëpo, për shkak të mungesës së transparencës, ende nuk ka detaje rreth kësaj çështje të rëndësishme. Sapo të kemi informacione të sakta dhe

të zyrtarizohet kjo shifër, Dega e PDK-së në Prizren do ta mbajë një konferencë enkas për çështjen në fjalë", është theksuar në reagimin e PDK-së në Prizren.

Inicohet bashkëpunimi në mes të UPZ-së dhe Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren



PRIZREN, 10 JANAR (ER) - Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, të premtën ka zhvilluar një vizitë në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, ku është takuar me përfaqësuesin Wolfgang Leidig dhe këshilltarin Muhamed Rexhepi. Në takim është diskutuar mundësia e arritjes së një marrëveshje të bashkëpunimit mes dy institucioneve, për konkretizimin e bashkëpunimit, posaçërisht me Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit dhe Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, që është paraparë në Studimin e Fizibilitetit për

ITP, pastaj Fakultetin e Ekonomisë dhe fakultetet e tjera, si dhe shkollën verore ndërkombëtare dhe Panairin e Karrierës. Po ashtu, që universiteti të jetë në dispozicion të ITP me shërbimet këshilluese dhe ekspertiza për biznese, industri, institucione dhe organizata të komunitetit që do të vendosen aty. Ndërsa hapësirat e banimit (konviktet) dhe mensa të jetë në dispozicion edhe të studentëve të universitetit. Në parim palët u pajtuan që arritja e marrëveshjes është e rëndësishme dhe pas kalimit të procedurave përkatëse të bëhet edhe formalizimi dhe zbatimi i saj brenda një afati të arsyeshëm.

Mbahet takimi i grupit punues për hartimin e planit të punës të Kuvendit të Mitrovicës


Mitrovicë, 10 janar (ER) - Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Safet Kamberi, së bashku me anëtarët e grupit punues, kanë mbajtur takimin e parë konstitiuv për hartimin e planit të punës së Kuvendit për

vitin 2020. Ky grup punues është i përbërë nga gjithsej nëntë anëtarë, të cilët kanë për detyrë ta hartojnë planin vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2020, pastaj ta procedojnë te Kuvendi i Komunës për miratim. Ndërkaq

në këtë takim është bërë edhe zgjedhja e kryetarit të komisionit, me ç'rast anëtarët e këtij grupi punues kanë zgjedhur unanimisht që kryetar të jetë anëtari nga Kuvendi Komunal, Vesel Neziri.



Përse më është kujtuar Xhavit Hoxha?



Nga Bedri ISLAMI

Nga ajo që po ndodh në Kosovë.

Presidenti i saj thërret tri herë në takim fituesin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Në tri herët merr tri përgjigje mohuese: "Nuk jam në Prishtinë", "kam punë të tjera", "do të vij një herë tjetër". Duket si një lojë fëmijësh, por nuk është kaq e thjeshtë.

Edhe presidenti dhe shefi i ardhshëm i qeverisë kanë kabinetet e tyre, njerëz të ditur dhe

servilë të hatashëm, protokol-larë dhe sekretarë dhe gjithçka mund të zgjidhet përmes tyre. Ndërlidhjet institucionale nuk bëhen përmes rrjeteve sociale. Pak më pas, shefi i ardhshëm i qeverisë i çon haber presidentit, "do të vij më 6 janar".

Presidenti publikon orën dhe shton diçka nga vetja. Tek ajo shtesa nga vetja është inati i fshehur.

Takohen, shkurt, nuk kanë kohë as për një kafe, askush nuk e di përse u takuan, mandatarit i ardhshëm deklaroi se është një takim rutinë, presidenti, përsëri përmes rrjeteve sociale, i përgjigjet se ke afat 48 orë për ta sjellë emrin e mandatarit. Në cilin ligj e gjen presidenti këtë afat kohor, askush nuk e di; as këshilltarët e tij që i rrinë rrotull.

Shkojnë 48 orë. Askush nuk ka pritur që në 48 orë të ketë një emër mandatarit. As vetë presidenti nuk e ka pritur. As shefi i ardhshëm i qeverisë nuk ka menduar se do t'ia dërgojë.

Në fund, pas 48 orëve, vjen haberi tjetër: do ta sjellim në ditët e ardhshme, nuk ka datë fikse, do ta sjellim përmes postës, dhe do të presim mandatin po përmes postës. Sikur të jetë fjala për një emërim bakalli e jo për njeriun në postin më të rëndësishëm të Kosovës: zemërimi mes tyre vazhdon.

Kosova ka 6 muaj që e di se cili do të jetë shefi i ardhshëm i qeverisë: LV nuk e di ende? E di, pak ditë më parë Kurti ka thënë se qeveria e tij varet nga LDK-ja e jo nga presidenti. LDK-ja e Mustafës ka hesapet e saj.

Lojë force apo dëshirë mosqeverisje?

Kosova nuk është as e Hashim Thaçit e as e Albin Kurtit! Aq më pak e Isa Mustafës! Ata, të dy, në daç të flasin me njëri-tjetrin e, po të duan të mos flasin kurrë, por Kosova nuk mund të mbahet peng.

Presidenti dhe shefi i ardhshëm i qeverisë nuk do të takohen më. Mandatimi do të bëhet përmes postës.

Tani pritet përgjigja e shefit të presidencës. E çfarë rëndësie ka?

Dhe më është kujtuar Xhavit Hoxha.

Xhavit Hoxha ishte një ndër figurat më fisnike që kam njohur në të gjithë jetën time. I mençur si pakkush, fjalurtë dhe njeri i ndershëm, atdhetar dhe i vendosur, profesor i shquar, i

burgosur politik, mik i madh dhe mirëpritës si pakkush; askush nuk u nda prej tij pa mësuar diçka të mirë dhe të dashur. Kur i vëllai, Heroi i Kosovës, Edmond Hoxha, lideri i studentëve, u vra më 31 janar 1997, nuk i pikoi loti, por i buroi fjala e mirë.

Një herë, pas luftës, në një qëndrim në shtëpinë e tij, duke parë se çka ndodhte në Kosovë, na pat thënë:

- More, këta nuk janë të zotë me drejtue as terminalin e autobusëve në Prishtinë, e jo një qeveri!!!

I pata kundërshtuar, e sot, ndërsa më kujtohet kjo thënie, e di mirë se unë isha i gabuari. Eh, Xhavit Hoxha, mik i madh, shkove para kohe, bashkë me Jashar Salihun, dy burra të mëdhenj e të urtë!

LV-ja dhe LDK-ja janë dy gjysma që nuk po e bëjnë një tërësi



Shkruan: Faton ABDULLAHU

E keqja është se ka shumë fakte për të konstatuar se edhe nëse e bëjnë nuk do të funksionojë. Ky nuk është paragjykimim im. Ky është gjykim në avancë, bazuar në paragjykimet që këto dy forca kanë për njëra-tjetrën e, si duket, ato janë më të forta se vetëdija shtetndërtuese dhe interesat e përgjithshme. Në këto bisedime LV-ja nuk është në element, ajo vazhdon të

mos e kuptojë se sa ka fituar në këto zgjedhje. LDK-ja më shumë se potencë për t'i marrë përgjegjësitë, ofron hezitim dhe prirje për fajësim të partnerit. Prandaj për shkak se krejt kjo nuk po funksionon ka disa zhvillime jo të zakonshme dhe kërkohen disa hapa të domosdoshëm.

1) Involvimi i ShBA-së. ShBA-ja ka qëndruar anash që nga përfundimi i zgjedhjeve. Ka qenë shumë korrekte edhe me deklarime edhe kur ka vizituar z. Kurti në selinë e LV-së me çka në një mënyrë ka pranuar se ai është kryeministër i ardhshëm. Por tani, për hir të shumë proceseve, z. Kosnet si ambasador i ShBA-së në Prishtinë duhet të involvohet drejtpërsëdrejti dhe t'i shoh mundësitë që të japë këshilla, sugjerime dhe vërejtje të drejtpërdrejta, që kjo situatë

të zhblokohet. Me vazhdimin e qëndrimit anash duke vlerësuar se po respektohet kështu sovraniteti dhe vullneti i qytetarit, z. Kosnet nuk do t'i kontribuojë as qytetarit as Kosovës.

2) Involvimi i presidentit. Mosintervenimi i presidentit tani mund të merret edhe si papërgjegjësi e tij për ta zhblokuar situatën në të mirë të themelimit të qeverisë. Për ta përsheptuar procesin e marrëveshjes ndërmjet LV-së dhe LDK-së, apo edhe për të kërkuar ndonjë zgjidhje tjetër, tani është i justifikueshëm involvimi i tij. Ai duhet dhe ka mundësi ta bëjë këtë në bashkëpunim me deputetët e Kuvendin dhe Gjykatën Kushtetuese.

3) Kalimi i kohës brenda së cilës pajustificueshëm nuk po krijohet qeveria, më së shumti

po e dëmton LV-në. Është krijuar bindja se LV - LDK nuk po pajtohen për ndarjen e pozitave, ndarjen e kulaçit të pushtetit. Kjo për LV-në është humbje e virgjërisë politike ende pa marrë pushtetin. Kurse janë të shumtë ata që po thonë - 'a ju thosha as këta nuk janë më të mirë'. Sa më shumë që po zgjatë marrëzja e mospajtimit, aq më shumë po forcohet kjo bindje. LDK-ja me pasivitet tradicional, duke mos lëshuar pe, po e dëmton pandalshëm politikisht LV-në. 4) LDK-ja është trimëruar krejt pa arsyeshëm nga takimi me përfaqësuesin e ShBA-së, Grenller. Në të vërtetë faza më e lartë e indikacioneve, se nuk po arrihet ky koalicion, do të jetë kur LDK-ja do të mundohet të krijojë përshtypje tek të gjithë, se Kurti nuk është i përshtatshëm për dialog me

Serbinë dhe se LDK-ja duhet të bashkëpunojë me SHBA-në dhe të mos pranojë ta bëjë qeverinë me LV-në mu për këtë arsye. Kjo përpjekje ka ndodhur deri-diku nga takimi në Berlin.

5) Përpjekjet e vazhdueshme për ta arsyetuar njëri apo fajësuar partinë tjetër për mosarritjen e marrëveshjes nuk e ndihmon pajtimin as fleksibilitetin e munguar. Përkundrazi po i trimëron edhe LV-në edhe LDK-në që të vazhdojnë, edhe ngeshëm edhe me kryeneçësi politike dhe pa përgjegjësi shtetformuese. Ato po shpresojnë se barrikadimi i tyre është i justifikueshëm dhe perceptimi para anëtarësisë është se po bëhet për parimet e proklamuar që herët. Jo, Jo, të dyja janë fajtoresh, janë shumë fajtoresh dhe të papërgjegjshme.

Rrënohet një objekt afarist në Vushtrri

VUSHTRRI, 10 JANAR (ER) - Drejtoria e Inspeksionit në Komunën e Vushtrrisë, në një aksion të asistuar edhe nga Policia e Kosovës, të premtën ka bërë rrënimin e një objekti afarist të ndërtuar pa leje në rrugën magjistrale Vushtrri - Prishtinë.

Pas rrënimin të objektit, Drejtoria Komonale e Inspeksionit ka njoftuar se me kohë e kanë paralajmëruar ndërtuesin si dhe kanë ndjekur të gjitha procedurat deri në vendimin përfundimtar për rrënim.

Drejtori i kësaj drejtorie, Rrahim Ajeti, ka thënë se me kohë i ka ndjekur të gjitha procedurat duke i vënë edhe shiritin e ndalimit të punimeve, por pronari i objektit nuk i ka ndaluar punimet.

Drejtori e Inspeksionit u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të cilët duan të bëjnë ndërtime të objekteve afariste apo të banimit që të pajisen me leje ndërtimi, përndryshe kjo drejtori është e obliguar që ta zbatojë ligjin dhe të marrë masa në përputhje të ligjit në fuqi.



Flotën e pestë amerikane e drejton një kapiten iranian

UASHINGTON, 10 JANAR - Tensionet midis ShBA-së dhe Iranit ka arritur kulmin e këtyre viteve të fundit, ku vrasja e gjeneralit Soleimani dhe sulmet raketore iraniane ndaj bazave amerikane në Irak për disa orë bënë të mendohej se një luftë e hapur midis dy vendeve kishte filluar. Por në qoftë se një sulm ajror amerikan do të ndodhte, me shumë mundësi ai do të niste nga aeroplanmbajtësja

bërthamore Harry S. Truman, që ndodhet në veri të Gjirit Persik me flotën e pestë amerikane. Po si paradoks, ky që është një nga mjetet më të fuqishme dhe të kushtueshme të forcave detare amerikane dhe drejtohet nga një person me origjinë dhe i rritur në Teheran. Kapiteni Kavon Hakimzadeh ka lindur në Teksas, i biri i një iraniani dhe një amerikaneje, dhe ka jetuar në vendin aziatik

deri në moshën 11-vjeçare. Familja e tij u largua pas revolucionit komeinist, duke u transferuar përfundimisht në ShBA. Kavon, që kolegët e thërrasin thjesht me nofkën "Hak", ka një karrierë ekselentë në ushtri, me misione në Irak dhe Afganistan që i kanë bërë të ngjisë hierarkinë ushtarake deri në komandën e një prej gjigantëve të detit, si aeroplanmbajtësja Truman.



Kriza në Iran dominon në takimin në mes të Merkelit dhe Putinit

Takimi Merkel - Putin pritet të përqendrohet në krizën e Iranit, ndërkohë që Gjermania dhe Rusia kanë bërë thirrje për uljen e përshkallëzimit midis Uashingtonit dhe Teheranit. Konflikti i Ukrainës është, gjithashtu, në rendin e ditës, krahas së ardhmes së gazsjellësit Nord Stream 2 nga Rusia në Gjermani, i cili po përballlet me kundërshtim të fortë nga ShBA-ja



BERLIN, 10 JANAR - Kancelarja gjermane Angela Merkel arrin sot (e shtunë) në Moskë për bisedime me presidentin rus Vladimir Putin. Takimi ka të ngjarë të përqendrohet në krizën e Iranit, ndërkohë që Gjermania dhe Rusia kanë bërë thirrje për uljen e përshkallëzimit midis Uashingtonit dhe Teheranit. Konflikti i Ukrainës është, gjithashtu, në rend të ditës, krahas së ardhmes së gazsjellësit Nord Stream 2 nga Rusia në Gjermani, i cili po përballlet me kundërshtim të fortë nga Shtetet e Bashkuara, ka njoftuar voa. Vladimir Putini bëri një udhëtim të rrallë në Siri të martën - vizita e tij e dytë që kur Rusia ndërhyri në vitin 2015 për të ndihmuar presidentin Bashar al-Asad në luftën civile të vendit. Me shqetësimin e saj në rritje për çështjet në Lindjen e Mesme, Rusia po përpiqet të paralajmërojë shpërthimin e një konflikti të ri në Iran, thotë analisti Andrew Foxall. "Irani i

jep presidentit Putin mundësinë që ta paraqesë veten si paqebërës dhe jo si "ndërmjetës". Dhe në këtë sens interesat e tij janë të vendosura në të njëjtën linjë me kancelaren Merkel pasi të dy besojnë të marrëveshja bërthamore e Iranit, të dy besojnë se diskutimi dhe debati janë shumë më të preferueshëm sesa konflikti dhe konfrontimi që po zhvillohet aktualisht mes Teheranit dhe Uashingtonit", thotë analisti Foxall. Evropa dhe Rusia po përpiqen ta mbajnë gjallë marrëveshjen bërthamore të viti 2015. Shtetet e Bashkuara thonë se marrëveshja ka vdekur. "Ka ardhur koha që Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca, Rusia dhe Kina ta njohin këtë realitet. Ata tani duhet të shkëputen nga mbetjet e marrëveshjes me Iranin", tha presidenti Trump. Shtetet e Bashkuara dhe Gjermania gjithashtu nuk janë dakord me ndërtimin e gazsjellësit Nord Stream 2 - nga Rusia në Gjermani. Uashingtoni ka vendosur sanksione ndaj kom-

panive të përfshira. Ish-Sekretari amerikan i Energjisë Rick Perry përsëriti shqetësimet e tij gjatë një udhëtimi në Lituani në tetor. "Nord Stream 2 është krijuar për të çuar një arterie me burim të vetëm në Evropë dhe një goditje në zemër të stabilitetit dhe sigurisë evropiane", tha ai. Ukraina - qendra tradicionale për transitimin e gazit rus drejt Evropës - rrezikon të humbasë tarifën e vlefshme të transitit. "Ajo që Rusia ka kërkuar të bëjë gjatë viteve të fundit, por ndoshta edhe më gjatë, është të krijojë një mosmarrëveshje në marrëdhëniet transatlantike duke përdorur çdo mjet ose

instrument që mund të identifikojë - dhe Nord Stream 2 i siguron Rusisë saktësisht këtë lloj mjeti. Nord Stream 2 padyshim që do të diskutohet në Moskë dhe do të sigurojë një mundësi për të dy - Merkelin dhe Putinin që të angazhohen përsëri në projekt dhe përsëri të argumentojnë se kjo nuk dëmton sigurinë e energjisë evropiane", thotë analisti Foxall. BE-ja vendosi sanksione ndaj Rusisë pas aneksimit me forcë të Krimesë dhe pushtimit të Ukrainës Lindore. Disa shtete evropiane - përfshirë Italinë dhe Hungarinë - po bëjnë përpjekje për t'u dhënë fund sanksioneve. "Nëse ai kërkon të gjejë një lidhje

të dobët të Bashkimit Evropian, më duket se nuk ka të ngjarë që kjo do të jetë Gjermania dhe kancelarja Merkel, e cila ka qenë në pararojë të argumentimeve për nevojën e këtyre sanksioneve", thotë analisti. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskiy ka ndërmarrë një qasje të re me Moskën - duke rënë dakord për një seri shkëmbimesh të burgosurish. Angela Merkel e Gjermanisë ka ofruar një mbështetje të fortë. Me tensione më të larta se në çdo kohë që nga Lufta e Ftohtë, takimi i saj me Vladimir Putinin do të vëzhgohet nga afër për çdo shenjë të një ndryshimi në marrëdhëniet Lindje-Perëndim.

Uashingtoni hedh poshtë kërkesën për tërheqje nga Iraku

Uashington, 10 janar - Uashingtoni kundërshtoi të premten një kërkesë irakiane për t'u përgatitur për t'i tërhequr trupat e saj, mes tensioneve të shtuara midis Uashingtonit dhe Teheranit, pas vrasjes në Bagdad të gjeneralit të lartë iranian. "Amerika është një

forcë që i shërben të mirës në Lindjen e Mesme", tha zëdhënësja e Departamentit të Shtetit. Ajo shoi se forcat ushtarake amerikane në Irak do të vazhdojnë luftën kundër ISIS-it dhe se mbeten të përkushtuara t'i mbrojmë amerikanët, iranianët dhe partnerët e koal-

cionit. Sipas Departamentit të Shtetit, çdo delegacion që do të dërgohet në Irak do të jetë i përkushtuar për të diskutuar se si të riangazhohemi më së miri në partneritetin tonë strategjik me Irakun dhe jo për të diskutuar tërheqjen e trupave atje.



'SOFRA' MBETET E SHTRUAR...

Rrustem Berisha: "Thërrime të sofrës së fundit", FAD, Prishtinë, 2019, f. 100



Sadri FETIU

Me siguri e kam thënë edhe më parë, por do ta përsëris edhe kësaj radhe: Rrustem Berisha është poet i lindur, që poezinë e ka pjesë të jetës së përditshme. Ai krijon poezi në momente të ndjeshme, duke poetizuar gjërat më të thjeshta të mjedisit të tij jetësor. Ai komunikon me vargje me njerëzit e tij të afërm sa herë që gjen shtegun që ta harmonizojë lidhjen midis të kaluarës dhe të sotmes, midis dashurisë, dhembjes, gëzimit dhe përmallimit. Ai krijon metafora të fuqishme që duken fare te thjeshta, siç është kjo në titullin e përmbledhjes së tij të re "Thërrime të sofrës së fundit". Shiheni se çfarë bukurie fshihin këto "thërrime",

"buke" të ëmbël, që e ushqejnë shpirtin në sofrën e madhe poetike. Ai do ta quajë këtë "sofra e fundit", por jo, unë nuk mund të pajtohem... Nuk dihet kurrë saktësisht as fillimi e as fundi i frymëzimit poetik, prandaj "sofra" mbetet gjithmonë e shtruar për ata që janë të uritur që ta shijojnë nektarin e "thërrimeve" poetike të shtruara në të...

Unë, ashtu si edhe më parë kur i kam lexuar tre përmbledhjet paraprijëse të sofrës: "Guri i Gjeranës", "Kroni i lejthisë" dhe "Lulet e Pleqërisë", mbase rastësisht e pata fatin të jem përsëri lexuesi i parë i poezisë më të re të Rrustem Berishës. Mund të them që në fillim se duke i lexuar poezitë e kësaj përmbledhjeje, përjetova një kënaqësi të dyfishtë.

Së pari, u kënaqa se miku im, Rrustemi, me gjithë moshën që ka, qëndron i fortë përballë kërkesave që shtron përpara tij frymëzimi poetik dhe vazhdon të shkruajë poezi të bukura.

Së dyti, brenda kësaj poezie unë vërejtja se janë përforcuar edhe më shumë disa nga parimet krijuese, që i karakterizojnë poetët e mirëfilltë, tek të cilët mbretëron çiltërsia e një ndenjeje përherë më të theksuar për t'i ofruar lexuesit anët më të padukshme të bukurisë së jetës, për t'i poetizuar ato raste të thjeshta, ato gjëra krejt të vogla që e prekin shpirtin dhe e nxisin atë që ta përjetojë më të plotë kuptimin e ekzistencës njerëzore.

Në këtë aspekt unë gjeta inde të ngjashme poetike me poezinë e Dritëro Agollit dhe të poetëve të tjerë të kësaj lagjeje që janë në gjendje ta poetizojnë edhe "gurin e thatë" të tokës së atdheut dhe shkretëtirën e thellë të humbëtirave të dhembjeve shpirtërore që njeriu mund t'i shkaktojë njeriut tjetër.

Duke lexuar poezinë e Rrustem Berishës edhe kësaj radhe e hasa atë konstatimin e njohur të poetit tonë të madh, Lasgush Poradecit, se poeti është

"përgjegjës" për të gjitha ndodhitë shoqërore. Brenda kësaj "përgjegjësie" Rrustem Berisha edhe kësaj radhe e ngrit zërin kundër të këqijave të përgjithshme, në radhë të parë kundër keqpërdorimeve dhe shfrytëzimit të pamëshirshëm të njerëzve dhe padrejtësive të mëdha shoqërore që po ndodhin sot në jetën tonë të përditshme, në Kosovën tonë të lirë... Duke vazhduar më tutje leximin e kësaj poezie njeriu mund ta përjetojë edhe ndjenjën sublime të dashurisë së pastër njerëzore, dhembjen për fatin e mërgimtarit, kujtimin mallëngjyes e melankolik për kohën e rinisë e, besa, edhe për atë nga mosha e fëmijërisë. Në këtë aspekt në poezinë e Rrustem Berishës gjejmë vazhdimësi të traditës sonë poetike që nga poezia melankolike e Ndre Mjedes e, mbase, edhe ajo e Lasgush Poradecit.

Në veçanti, do të theksoj edhe kësaj radhe se Rrustemi është

poet fort i frymëzuar që ka një qasje interesante ndaj botës së fëmijëve. Duke evokuar kujtimet e tij të bukura nga fëmijëria e tij, ai ofron imazhe të bukura për jetën e një brezi të tërë dhe u ofron lexuesve të sotëm një njohje të plotë për të kaluarën, e cila, me gjithë varfërinë e skamjen, kishte bukurinë e vet, të cilën e përjetonin fëmijët e asaj kohe.

Duke mos dashur t'i përsëris ato që i kam thënë në vlerësimet për tre përmbledhjet e mëparshme të poezive të Rrustem Berishës, në fund do të konstatoj se poeti ka mbetur si gjithnjë i afërt me lexuesin, me një qasje fort modeste ndaj poezisë së tij, që e minimizon me anë të një metafore fort të rrallë, por kuptimplote: ai i quan "thërrime", por ato ofrojnë ushqim të plotë për të gjithë ata që din ta shijojnë "bukën" e "sofrës" poetike, e cila mbetet përgjithmonë e shtruar, si për shtegtarin e rastit, ashtu edhe për mikun e shtëpisë...

Ambasadori i Republikës së Kosovës në Austri, z. Sami Ukelli, nderoi veprimtarin e madh dhe shkencëtarin prof. dr. Eqrem Zenelaj




Prof. dr. Eqrem Zenelaj u prit në Ambasadë nga ambasadori, z. Sami Ukelli, i cili, para se t'ia dhurojë mirënjohjen, foli fjalë të mëdha dhe vlerësime për aktivitetin shkencor e kulturor të profesor Zenelajt. Ai tha se njerëzit e shkencës e të dijes e të kulturës si prof. Zenelaj meritojnë edhe më shumë se një

mirënjohje, por ne si Ambasada kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Profesorin i cili me arritjet dhe botimet e hulumtimit na bënë krenarë si shqiptarë dhe Kosovë.

Ndërsa prof. Zenelaj e falënderoi ambasador Ukellin për punën e shkëlqyer si ambasador

i Kosovës në Austri. Prof. Zenelaj tha se krenohem me përfaqësimin diplomatik që zoti ambasador bën në Austri për krijimin e një klime bashkëpunimi me shkencëtarë e njerëz të kulturës në mërgatën shqiptare si dhe në mbështetjen të vazhdueshme të vlerave kulturore historike e shkencore.



E rrallë

"Mbreti i tonit" blen peshkun ton për 1.8 milion dollarë

Një japonez ka shpenzuar 1.8 milion dollarë për të blerë një peshk ton gjigant në një ankand. Kiyoshi Kimura, i mbiqajturi "Mbreti i Tonit" dhe që drejton një zinxhir restorantesh Sushi Zanmai, pagoi shifrën marramendëse për peshkun 276 kilogramë, ka njoftuar televizioni publik NHK. Megjithatë, kjo nuk është shifra më e madhe që ka paguar ndonjëherë për një



peshk ton. Në ankandin e vitit të kaluar biznesmeni pagoi shifrën rekord prej 3.1 milionë dollarësh për një peshk gati 277 kilogramë.

FOTO E DITES



Efektivët e kursit XV Komando të Shqipërisë po stërviten në terrene alpine përpara se të bëhen pjesë e njësisë elitë të Forcave të Armatosura.

E jashtëzakonshme

Alienët ekzistojnë dhe ata jetojnë mes nesh

Astronautja e parë femër që udhëtoi në hapësirë, Helen Sharman, "hodhi bombën" duke deklaruar se alienët ekzistojnë. Gjatë një interviste për revistën "Observer" ajo ka thënë se hapësira është e përbërë nga miliarda yje dhe domosdoshmërisht ka gjallesa të tjera përveç njerëzve. Ajo beson



se alienët mund të kenë përbërje tjetër kimike nga ajo e njerëzve dhe se ata mund të jetojnë rreth nesh, por ne nuk mund t'i shohim.

BARSOLETA E DITËS



Djali: Babi, babi ku gjendet Afrika.
Babai: Paj... nuk e di bre bir, veç sigurisht nuk është larg, se në punë tek unë punon një zezak e gjithmonë vjen me biçikletë e nuk vonohet.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).




DASHI
Me Diellin dhe Hënën disonante,

përpuni të keni një humor pozitiv për të zgjidhur konfliktet e vjetra.



DEMI
Të favorizuar nga Hëna do të keni

mundësi të angazhoheni në projektet që keni dashur prej shumë kohësh.



BINJAKËT
Çfarëdo që të keni në mendje,

meditoni çdo zgjedhje, çdo vendim, veçanërisht nëse ka para, biznes, investime në fjalë.



GAFORRJA
Mundohuni të mos veproni impul-

sivisht: kjo ditë e shënuar nga faza e Hënës së plotë në shenjën tuaj, kërkon vëmendje, durim dhe reflektim!



LUANI
Gaboheni nëse mendoni se partneri

është drejtpërdrejt përgjegjës për gjendjen tuaj të keqe.



VI RGJËRESHA
Ju do të dilni fitimtar në një

padrejtësi të bërë nga të tjerët, por nga kjo ju do të merrni disa mësimë të mira.



PESHORJA
Qëndrueshmëria nuk është pika juaj e

fortë, por është e tepërt të presësh që të tjerët të përshtaten me ndryshimet e humorit tënd!



AKREPI
Në punë do të jepni ide interesante

dhe projektet fituese që mund të zhvillohen me qetësi në të ardhmen.



SHIGJETARI
Tani për tani do ta keni shumë të

lehtë t'i afroheni dikujt që e pëlqeni dhe keni ndjenja.



BRICJAPI
Mosmarrëveshjet me njerëzit e

afërt do të zgjidhen dhe do të jenë në favorin tuaj, nëse flisni dhe veproni qartë, duke dëgjuar edhe mendimin e të tjerëve.



UJORI
Nëse flisni për dashuri, një jetë

plot aventura është e këndshme, por të kesh një person të cilit i beson është gjë tjetër.



PESHQIT
Dita është fantastike

nga shumë këndvështrime, një ilaç për humorin, veçanërisht nëse planifikoni takime prestigjioze.

Elton Deda për Festivalin e RTSh-së: Muzika ishte playback



Edhe pse tashmë kanë kaluar javë që nga Festivali i Këngës në RTSh, komentet dhe kritikant vijnë të jenë të shumta. Vëmendjen këtë herë e ka tërhequr një deklaratë e kompozitorit të njohur Elton Deda. Deda ka komentuar përshtypjet e tij mbi organizimin dhe këngët e festivalit. Ai nuk i ka kursyer komplimentet

për dy këngët protagoniste të këtij edicioni, "Shaj" dhe "Me tana". Por fjalë kritike ka rezervuar për detaje të tjera si muzika, duartrokitjet playback apo të qeshurat, duke i quajtur qesharake. "Muzikë e shtuar me playback, të qeshura me playback, duartrokitje me playback", u shpreh Eltoni duke e quajtur këtë gjë të dalë mode.



Vetëm dy ditë pas njoftimit të befasishëm Meghan Markle largohet nga Britania

Dukesha e Sussexit, Meghan Markle, është rikthyer në Kanada për t'u bashkuar me djalin e saj, Archie, ndërsa bashkëshorti i saj Princ Harry po përpiqet ta mbajë nën kontroll familjen

Mbretërore. Largimi për në Kanada vjen vetëm dy ditë pasi Harry dhe Meghan bënë njoftimin e befasishëm se do të largohen nga rolet e tyre mbretërore dhe do të bëhen të pavarur financiarisht.

Arbër Krasniqi sjell këngën e re "The End Is Here"



Arbër Krasniqi sapo e ka lansuar këngën më të re "The End Is Here". Tekstin, këndimin dhe miksimin i ka bërë

vetë ai, ndërsa për solon në kitarë është përkujdesur Leonard Canhasi. Arbëri është kompozitor i muzikës filmike dhe teatrale.


Leonardo DiCaprio përjeton një tjetër "Titanic"



Ylli i filmit "Titanic", Leonardo DiCaprio, ka përjetuar një aventurë interesante në det para ndërrimit të viteve. Aktori i famshëm i Hollywoodit është kthyer në një hero duke shpëtuar me jahtin e tij privat një 24-vjeçar francez që kishte mbi 11 orë në ujë. Marinari në gjendje të dehur si duket kishte rënë aksidentalisht nga

anija turistike e Klubit Med në det, pranë St Martin në Karaibe. Më 30 dhjetor, Di Caprio ishte me pushime me të dashurën 22-vjeçare Camila Morrone. Duke lundruar me varkë, bashkë me disa miq, ata dëgjuan thirrjen e emergjencës. Fatmirësisht ata e shpëtuan personin një orë para perëndimit, ndërkohë që po afronte stuhia.

Leonardo da Vinci: Unë di edhe të pikturoj



Nga Walter ISAACSON

Sapo arriti në atë momentin e padëshiruar të të mbushurit tridhjetë vjeç, Leonardo da Vinci i shkroi një letër sundimtarit të Milanos, ku i listonte arsytet përse ai duhet t'i ofronte një vend pune. Ai kishte qenë një piktor pak a shumë i suksesshëm në Firence, por kishte pasur probleme në përfundimin e pikturave që i kishin porositur e tashmë ishte në kërkim të horizonteve të reja. Në dhjetë paragrafët e parë, ai u bëri një përmbledhje dhuntive të tij inxhinierike, përfshirë edhe aftësinë për të ndërtuar ura, kanalizime uji, topa, mjete ushtarake të blinduara dhe godina publike. Vetëm në paragrafin e njëmbëdhjetë, diku nga fundi, ai shtoi se ishte edhe artist. "Sikurse edhe në pikturë, unë mund të bëj gjithçka", - shkroi ai.

Po, ai mund të bënte gjithçka. Ai do krijonte dy pikturat më të famshme të historisë, Darka e fundit dhe Mona Lisa. Por në mendjen e tij ai ishte po kaq i talentuar si njeri i shkencës dhe inxhinierisë. Me një pasion të gjallë, por edhe të fiksuar, ai kreu studime që përbënin risi në anatomi, fosile, zogj, mbi zemrën, makineritë fluturuese, optikën, botanikën, gjeologjinë, rrjedhën e ujit dhe armatimet; duke u bërë kështu prototipi i Njeriut të Rilindjes, një frymëzim për të gjithë ata të cilët besojnë se "veprat e pafundme të natyrës", siç i quante ai, janë të thurura së bashku në një harmoni të mbushur me modele të mrekullueshme. Aftësia e tij për të ndërthurrur artin dhe shkencën, e shndërruar në ikonë përmes vizatimit të tij të një njeriu me përmasa perfekte me krahët hapur brenda një rrethi e katrori, i njohur si Njeriu Vitruvian, e bëri atë gjenium më krijues të historisë. Zbulimet e tij shkencore e furnizonin me dije artin e tij. Ai rripte lëkurën nga fytyrat e kufomave, analizonte muskujt që kryejnë lëvizjen e buzëve, e më pas pikturoi buzëqeshjen më të paharueshme të botës. Studioi kafkën njerëzore, bëri vizatime të detajuara të kockave dhe dhëmbëve dhe krijoi agoninë në skeletin e Shën Jeromi në shkretëtirë. Eksploroj matematikën e optikës, pasqyroj se si rezet e dritës godasin kornenë e syrit njerëzor, e kështu prodhoi iluzione magjike të ndryshimit të perspektivës pamore te vepra e tij Darka e fundit.

Duke lidhur studimet e dritës dhe optikës me artin e tij, ai u bë mjeshtër i përdorimit të hijes dhe perspektivës për të modeluar objektet në një sipërfaqe dydimensionale, duke i bërë ato të duken si tredimensionale. Kjo aftësi "për ta bërë një sipërfaqe të sheshtë të paraqesë një objekt të modeluar dhe të ndarë nga plani, - tha Leonardo, - ishte synimi parësor i piktorit". Kryesisht për shkak të punës së tij, dimensionin u shndërrua si risia supreme e artit të Rilindjes.

Teksa plakej, ai vazhdoi me zbulimet e tij shkencore jo për t'i shërbyer artit, por i udhëhequr nga një instinkt ngazëllues për të kuptuar sa më mirë bukuritë e thella të natyrës. Kur nisi të studionte teorinë se përse qielli na duket ngjyrë blu, kjo nuk ishte vetëm për të fituar njohuri që të mund t'i përdorte në pikturat e tij. Kurioziteti i tij ishte thjesht një fanatizëm i pastër, personal dhe i bukur.

Por edhe teksta merrej me studimin e qiellit blu, shkenca e tij nuk ishte e ndarë prej artit. Të dyja ato i shërbenin pasionit të tij energjik, që nuk ishte gjë tjetër veçse dëshira për të ditur çdo gjë mbi botën, përfshirë edhe pozicionin që ka njeriu në të. Ai kishte një vlerësim për gjithësinë e natyrës dhe ishte i dashuruar pas harmonisë së modeleve të saj, të cilat i shihte të përsëritura në fenomene të vogla e të mëdha. Në blloqet e tij të shënimeve ai do vizatonte flokë kaçurrela, dallgë uji, vorbulla ajri, bashkë me disa formula matematikore që i shpjego-

gonin të tilla spirale. Në Kështjellën Windsor, teksa po shikoja "Skicat e turbullta" të cilat ai i bëri në prag të fundit të jetës, pyeta kuratorin Martin Clayton nëse mendonte se Leonardo i kishte bërë ato si vepra arti apo studime shkencore. Teksa po flisja, e kuptova vetë që ishte një pyetje pa vend. "Nuk besoj se Leonardo do e kishte bërë dot dallimin", - u përgjig ai.

Vendosa ta shkruaj këtë libër, pasi Leonardo da Vinci është shembulli i përkryer i tematikës kryesore të biografive të mia të mëparshme: se si aftësia për të lidhur disiplina të ndryshme, si arti dhe shkenca, shkencat shoqërore dhe teknologjia, përbëjnë çelësin e rrisë, imagjinatës dhe gjenialitetit. Benjamin Franklin, një figurë që e kam trajtuar në të shkuarën, ishte një Leonardo për epokën e tij: pa asnjë shkollim, ai u vetarsimua duke u bërë një dijetar tejet krijues dhe shkencëtar, shpikësi, diplomati, shkrimtari dhe strategu i biznesit, më i miri i iluminizmit në Amerikë. Përmes një balone në fluturim, vërtetoi se vetëtimja është elektricitet dhe shpiku rrufepritësin për ta zburat atë. Ai skicoi gjyzykë me dy vatra përqendrimi, instrumente muzikore që të mahnitnin, soba me djegie të pastër, bëri harta të gjirit të detit dhe themeloi stilin e veçantë të humorit amerikan. Albert Einstein, teksa haste vështirësi në studimet e tij mbi teorinë e relativitetit, merrte violinën dhe luante Mozart-in, dhe kjo e ndihmonte të lidhej sërish



me harmoninë e kozmosit. Ada Lovelace, së cilës i dedikova një profil në një libër për shpikësit, kombinoi ndjeshmërinë poetike të babait të saj, Lord Byron, me dashurinë e nënës së saj për bukurinë e matematikës, duke hedhur idenë e parë për një kompjuter me funksione të përgjithshme. Dhe Steve Jobs arriti kulmin e shitjeve të produktit të tij përmes një imazhi të shenjave rrugore, ku tregonte ndërthurjen e arteve liberale me teknologjinë. Leonardo ishte heroi i tij. "Ai e shikonte bukurinë si në art ashtu edhe në inxhinieri, - tha Jobs, - dhe aftësia e tij për t'i kombinuar të dyja ishte ajo që e bënte atë një gjeni".


Po, ai ishte gjeni: me një imagjinatë të shfrenuar, kuriozitet të zjarrtë dhe aftësi krijuese në shumë disiplina. Por këtë fjalë duhet ta përdorim me kujdes. Duke i vënë Leonardos etiketën "gjeni", në njëfarë mënyre, ia ulim disi vlerat, pasi e bëjmë të duket sikur ishte i goditur nga rrufeja. Biografi i tij i hershëm, Giorgio Vasari, një artist i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, e bëri këtë gabim: "Ndodh që, në një mënyrë mbinatyrore, një personi të vetëm i dhurohet me bollëk nga qielli bukur, hir dhe talent aq i madh, saqë çdo vepër e tij është hyjnore dhe çdo gjë që bën duket qartë që vjen nga Perëndia dhe jo nga arti njerëzor." Në fakt, gjenialiteti i Leonardos ishte njerëzor, i nxitur nga vullneti dhe ambicia e tij. Nuk vinte si dhorat hyjnore, ashtu si Newton apo Einstein, të cilët kishin një mendje me një fuqi aq të madhe funksionale, saqë ne njerëzit e thjeshtë nuk mund ta kuptojmë. Leonardo pothuajse ishte pa shkollë dhe me vështirësi arrinte të lexonte latinisht apo të bënte përlogaritje matematikore disashifrore. Gjenialiteti i tij i përkiste një lloji të cilin ne mund ta kuptojmë, madje edhe ta përdorim si shembull. Ishte i bazuar mbi aftësi të cilat ne mund të aspirojmë që t'i arrijmë te vetja jonë, si, për shembull, kurioziteti dhe vëzhgimi intensiv. Ai kishte një imagjinatë aq joshëse e cila lodronte me skajet e fantazisë, gjë që edhe ne duhet të përpiqemi ta

ruajmë te vetja jonë dhe duhet t'ua pasojmë edhe fëmijëve tanë.

Fantazitë e Leonardos shpaloseshin në çdo gjë që ai prekte: shfaqje teatrale, planet për ndryshimin e rrjedhës së ujit, skica për qytetet ideale, skema për makineri fluturuese dhe pothuajse çdo aspekt tjetër i artit të tij dhe inxhinierisë. Letra e tij drejtuar sundimtarit të Milanos është një shembull i mirë për këtë, pasi aftësitë e tij mbi inxhinierinë ushtarake vetëm sa i kishte në mendje. Roli i tij i parë në oborrin e sundimtarit nuk ishte për ndërtimin e armëve, por për të organizuar festivale e parada. Edhe në kulmin e karrierës së tij, shumica e makinerive të tij luftuese apo fluturuese ishin më shumë vizionare sesa praktike.

Në fillim unë mendova se ndjeshmëria e tij ndaj fantazisë ishte një dështim, që shpaloset në mungesën e disiplinës dhe zellit, dhe në prirjen për të lënë përgjysmë vepra arti apo duke lënë pa përfunduar studime të ndryshme. Vizioni pa zbatueshmërinë është vetëm një iluzion. Por unë zbulova se aftësia e tij për të zburat vijën ndarëse midis realitetit dhe fantazisë, ashtu si edhe teknika e sfumaturës për zbutjen e vijave në pikturë, ishte çelësi i krijimtarisë së tij. Aftësia pa imagjinatë është shterpë. Leonardo dinte si të mblesëronte vëzhgimin me imagjinatën, ndaj edhe mbetet novatori më i madh i historisë.

Pikënisja ime për këtë libër nuk ishin kryeveprat artistike të Leonardos, por blloqet e tij të shënimeve. Unë mendoj se mendja e tij shpaloset më mirë te mbi 7.200 faqet e blloqeve dhe shënimeve të tij, të cilat, për mrekulli, mbijetuan deri në ditët e sotme. Na doli që letra zenka një teknologji e jashtëzakonshme e ruajtjes së informacionit, e lexueshme edhe pas pesëqind vitesh, gjë që është e vështirë të thuhet për shënimet tona në rrjetet sociale. Fatmirësisht, Leonardos nuk ia mbante xhepi ta shpërdoronte letrën, kështu ai mbushi çdo cep të faqes me vizatime të shumëllojshme dhe me shënime të vogla për t'u lexuar me lupë, të cilat duken të zakonshme, por na japin



informacion mbi ecurinë e mendjes së tij. Të shkarravitura krahanjërë-tjetërës, pa lidhje midis tyre, gjenden përlogaritje matematikore, vizatime të të dashurit të tij të ri mistrec, zogj, makineri fluturuese, zbukurime teatri, valë deti, valvulat e gjakut, koka groteske, engjëj, sifone, kërcej bimësh, kafka të prera, këshilla për piktorët, shënime për syrin dhe optikën, armë lufte, fabula, gjëgjëza dhe studime për piktura. Madhështia ndërdisiplinore shpaloset në çdo faqe, duke na ofruar një pamje të mrekullueshme të një mendjeje që vallëzon me natyrën. Blloqet e tij të shënimeve janë të dhënat më të mëdha që ka krijuar ndonjëherë kurioziteti njerëzor, një guidë mahnitëse e njeriut të cilin historiani i shquar i artit Kenneth Clark e quajti "mendja me kuriozitetin më të pakapërcyeshëm të historisë". Perlat e mia të preferuara në blloqet e tij të shënimeve janë listat e gjërave që planifikon të bëjë. Njëra prej tyre, e cila daton në vitet 1490 në Milano, është lista e gjërave që dëshiron të mësojë për atë ditë. "Matja e Milanos dhe rrethinave të qytetit", është e para në listë. Kjo ka një qëllim praktik, pasi shpjegohet nga një shënim tjetër në listë: "Vizato Milanon." Shënimet e tjera tregojnë që ai kërkonte me këmbëngulje të gjente njerëz të tjerë që t'i mësonin gjërat që ai nuk i dinte: "Gjej mjeshtrin e aritmetikës të të mësojë se si të sheshosh një trekëndësh... Pyet Giannino bombarduesin sesi është e rrethuar kulla e Ferrarës... Pyet Benedetto Protiniari-n sesi arrijnë të ecin mbi akull flemingët në zonat e ulëta... Gjej mjeshtrin e hidraulikëve të të mësojë sesi të riparosh një grup, një kanal dhe një mulli sipas mënyrës në Lombardi... Gjej përmasat e diellit siç të ka premtuar mjeshtri Giovanni Francese, të cilin e thërrasin Francezi." Ai është i pangopur për dije.

Herë pas here, vit pas viti, Leonardo liston gjërat që duhet të bëjë apo mësojë. Disa prej tyre kanë të bëjnë me studime të detajuara, të cilat neve as që na shkon në mendje t'i bëjmë. "Studio këmbën e patës: nëse do ishte gjithmonë e hapur ose gjithmonë e mbyllur, shpendi nuk do ishte në gjendje të bënte as edhe një lëvizje." Të tjerat kanë të bëjnë me pyetje, si përse është qielli blu apo fenomene aq të zakonshme, sa që neve as na shkon në mendje t'i mendojmë. "Përse peshku në ujë është më i shpejtë sesa zogu në ajër, kur duhet të jetë e kundërta, duke qenë se uji është më i rëndë dhe më i trashë sesa ajri?"

Më të mirat janë ato pyetjet të cilat duket se janë tërësisht të rastësishme. "Përshkruaj gjuhën e qukapikut", - udhëzon ai veten. E kujt në këtë botë do t'i shkrepse në mendje që një ditë, pa as edhe një arsye, do donte të dinte se ç'pamje ka gjuha e qukapikut? E si do ta zbulosh këtë? Dhe nuk është as informacion që Leonardos i duhej për të pikturuar një tablo apo për të kuptuar fluturimin e zogjve. Por ja që është në ato shënime dhe siç do e shohim më vonë, ka gjëra të mrekullueshme që mund të mësojmë për gjuhën e qukapikut. Por arsyeja kryesore përse ai donte ta dinte ishte sepse ai ishte

Leonardo: kurioz, pasionant dhe gjithnjë i mbushur me habi. Por më i çuditshmi është ky shënim: "Shko çdo të shtunë te banja e nxehtë ku do shohësh burra lakuriq." Arrijmë ta imagjinojmë Leonardon duke e bërë këtë, për arsye anatomike dhe estetike. Por a duhej ta kujtonte veten që të shkonte e ta bënte këtë? Tjetra në listë është: "Fry mushkëritë e derrit dhe vëzhgo nëse zgjerohen në gjerësi dhe gjatësi, apo vetëm në gjerësi." Ashtu siç shkroi kritiku i artit për New Yorker, Adam Gopnik, "Leonardo mbetet i çuditshëm, më i çuditshëm s'ka ku të vejë, dhe nuk kemi se çfarë t'i bëjmë këtij fakti".

Për t'i shtjelluar këto çështje, vendosa të shkruaj një libër që të bazohet kryesisht mbi këto blloqe shënimesh. Nisa me pelegrinazhet e mia për të parë origjinalet në Milano, Firenze, Paris, Siatell, Madrid, Londër dhe në Kështjellën Windsor. Ky ishte zbatim i urdhrat të Leonardos që për të nisur një studim, duhet të shkosh te burimi: "Ai që mund të shkojë te burimi i ujit, nuk shkon te brokja me ujë." Gjithashtu u zhyta në pirgun e artikujve shkencorë dhe disertacionet doktorale mbi Leonardon, ku secili prej tyre përmban vite të tëra pune për tema të caktuara. Gjatë dekadave të fundit, sidomos që nga zbulimi në vitin 1965 i shënimeve të tij, që njihen si Kodikët Madrid, ka pasur shumë përparime në analizimin dhe interpretimin e shkrimeve të tij. Gjithashtu, teknologjia moderne na ka zbuluar informacione të reja mbi pikturat e tij dhe teknikat që përdorte.

Pasi u angazhova i tëri me Leonardon, bëra aq sa munda që të isha më vëzhgues ndaj fenomeneve të cilat më parë i injoroja, duke u përpjekur që t'i shikoj gjërat ashtu siç i shikonte ai. Kur pashë dritën e diellit që përplasej te perdet, e binda veten të ndaloja e të shikoj se si hijet përkëdhelhin palat. U përpoqa të shoh se si drita e reflektuar nga një objekt ngjyroste me delikatesë hijet e një objekti tjetër. Vura re se si shkëlqimi i një pike të shndritshme mbi një sipërfaqe të lëmuar lëvizte kur unë tundja kokën. Kur shikoj një pemë larg e një tjetër më pranë meje, përpiqesha të krijoja imazhin e linjave të perspektivës. Kur pashë një spirale uji, e krahasova me flokët kaçurrela. Kur nuk e kuptoja dot një koncept matematikor, përpiqesha sa të mundja ta imagjinoja si një figurë. Kur shikoj njerëz që darkonin së bashku, studiova marrëdhënien midis lëvizjeve dhe emocioneve të tyre. Kur pashë lindjen e një buzëqeshjeje në buzët e dikujt, u përpoqa të kuptoja misteret e brendshme të njeriut.

Jo, as që iu afrova Leonardos, as të kuptoja si ai e as të fitoja ndonjë talent sado të vogël me talentin e tij. As që iu afrova qoftë edhe një milimetër aftësisë për të skicuuar një makinë fluturuese, të shpikja një mënyrë të re për të bërë harta, apo të pikturoja Mona Lisën. E forcova veten e me detyrim u bëra kurioz për gjuhën e qukapikut. Por mësova nga Leonardo se si dëshira për t'u mahnitur me botën që ne hasim çdo ditë mund


ta bëjë më të pasur çdo moment të jetës sonë.

Ka tre dëshmi madhore mbi Leonardon nga shkrimtarë të cilët pothuajse ishin bashkëkohësit e tij. Piktori Giorgio Vasari, i lindur në vitin 1511 (tetë vite përpara se të vdiste Leonardo), shkroi librin e parë të vërtetë mbi historinë e artit, *Jetët e piktorëve, skulptorëve dhe arkitektëve më të shquar*, i botuar në vitin 1550, dhe u ribotua në vitin 1568 me korrigjime të bazuara mbi intervista të tjera me njerëz të cilët e njihnin Leonardon, përfshi edhe nxënësin e tij Francesco Melzi. Një shovinist florentin, Vasari i përkušttoi Leonardos, sidomos Mikelanxhelos, respektin më të plotë për krijimin e asaj që ai e quajti, për herë të parë e shkruar në letër, një "rilindje" në art. Ashtu siç Huckleberry Finn tha për Mark Twain, kishte gjëra që Vasari i ekzagjeroi paksa, por në të shumtën e rasteve tha të vërtetën. Ajo që na mbetet është një përzierje thashethemesh, zbukurimesh, sajesh dhe gabimesh të paqëllimshme. Problemi qëndron se në cilën prej tyre hyjnë ato anekdotat aq piktoreske - si për shembull, ajo e mësuesit të Leonardos që e hodhi penelin e vet kur pa talentin e nxënësit të tij.

Dorëshkrimi anonim i shkruar gjatë viteve 1540, i njohur si "Anonimo Gaddiano", sipas emrit të familjes që e zotëronte dikur, përmban detaje shumëngjyrëshe mbi Leonardon dhe florentinën të tjerë. Edhe këtu, disa prej pohimeve në këtë dorëshkrim, si, për shembull, Leonardo jetoi dhe punoi me Lorenzo de' Medici, mund të jetë e zbuluar, por na jep detaje interesante që tingëllojnë të vërteta. Për shembull, Leonardos i pëlqente të vishte tunikë ngjyrë rozë e cila i varej deri te gjunjët, ndonëse të tjerët vishnin rroba të gjata.

Gurimi i tretë i hershëm është nga Gian Paolo Lomazzo, një piktor i cili u bë shkrimtar e më pas u verbua. Rreth vitit 1560 ai shkroi një dorëshkrim të titulluar *Ëndrrat dhe argumentet i cili u botua më vonë në vitin 1584* si një tekst voluminoz mbi artin. Ai ishte nxënës i një piktori i cili e kishte njohur Leonardon dhe ai intervistoi Melzin, nxënësin e Leonardos, duke bërë kështu të kishte informacion të dorës së parë mbi historitë e mjeshtrit. Lomazzo zbulon shumë të dhëna mbi prirjet seksuale të Leonardos. Për më tepër, ka edhe dorëshkrime të tjera më të shkurtra prej dy bashkëkohësve të Leonardos, Antonio Billi, një tregtar florentin, dhe Paolo Giovio, një mjek dhe historian italian.

Shumë prej këtyre dokumenteve të hershme përmendin pamjen dhe personalitetin e Leonardos. Ai përshkruhet si një njeri i pashëm dhe i hirshëm. Kishte kaçurrela të derdhura dhe të arta, një trup muskuloz, një forcë fizike të admirueshme dhe një elegancë në sjellje teksta shëtiste nëpër qytet me veshjen e tij shumëngjyrëshe apo kur ngiste kalin. "I bukur në pamje dhe në personalitet, Leonardo ishte tërheqës dhe plot hir", - shkruhet në dorëshkrimin e



Njeriu Vitruvian, rreth 1490

Anonimo-s. Për më tepër, ai ishte një bashkëbisedues tejet tërheqës dhe i dashuruar pas natyrës, i njohur si njeri i ëmbël dhe i dashur si me njerëzit ashtu edhe me kafshët.

Ka më pak pajtueshmëri për disa specifika të veçanta. Gjatë studimit tim zbulova se shumë fakte mbi jetën e Leonardos, që nga lindja e deri te vdekja e tij, kanë qenë temë debati, miti dhe misteri. Do përpigem të jap vlerësimin tim më të mirë e të përshkruaj polemikat dhe kundërgargumentet përmes shënimeve.

Gjithashtu zbulova, si fillim u shtanga, por më pas e pashë si kënaqësi, që Leonardo nuk ishte gjithmonë një gjigant. Ai bënte gabime. Merrej me gjëra pa lidhje, sinqerisht e kam, ndiqte probleme matematikore që vetëm sa ia çonin kohën dem. Fatkeqësisht, shumë prej pikturave të tij i la pa përfunduar, në veçanti Adhurimi i mbretit, Shën Jeromi në shkretëtirë dhe Beteja e Anghiari-t. Kësisoj, sot kemi vetëm pesëmbëdhjetë piktura që i atribuohen plotësisht apo pjesërisht atij. Ndonëse në përgjithësi ai konsiderohej nga bashkëkohësit e tij si miqësor dhe i sjellshëm, kishte raste kur Leonardo ishte i zymtë dhe i trazuar. Shënime dhe vizatimet e tij janë dritare e qartë e mendjes së tij eksituese, imagjinare, maniake, e me raste, edhe e ngazëllyer. Nëse do kishte qenë student në fillim të shekullit të njëzetë e një, do i kishin dhënë një recetë me ilaçe për të stabilizuar luhatjet e humorit dhe çrregullimin e mungesës së vëmendjes. Askush nuk duhet t'u bashkohet opinionistëve të cilët e konsiderojnë atë si një artist gjeni të trazuar, për të besuar se ne jemi me fat që Leonardo ishte i lirë të përdorte veset e tij për të masakruar demonët e tij e për të zgjuar dragonjtë.

Në një nga gjëgjëzat në blloqet e tij të shënimeve gjendet kjo e dhënë: "Figura të mëdha do shfaqen në formën njerëzore dhe sa më shumë t'i afrosh, aq më shumë përmasat e tyre të stërmëdha do zvogëlohen." Përgjigja është kjo: "Hija e njeriut gjatë natës me një dritë." Ndonëse e njëjta gjë mund të thuhet për Leonardon, në fakt, unë besoj se ai nuk zvogëlohet nëse zbulohet se është njeri. Si hija, ashtu edhe realiteti i tij, meritojnë të shihen si madhështore. Gabimet dhe sjelljet e tij të çuditshme na bëjnë që edhe ne të identifikohemi me të, të ndihemi se edhe ne mund të matemi me të dhe t'i vlerësojmë edhe më shumë momentet e triumfit të tij.

Shekulli i pesëmbëdhjetë i Leonardos, Columbus dhe Gutenberg, ishte koha e novacionit, e zbulimit dhe përhapjes së dijes përmes teknologjive të reja. Thënë shkurt, ishte një kohë si kjo e jona. Ndaj edhe ne kemi shumë për të mësuar nga Leonardo. Aftësia e tij për të ndërthurur artin, shkencën, teknologjinë dhe imagjinatën mbetet një recetë e përjetshme për krijimtarinë. Kështu ishte edhe stili i tij i jetesës, paksa mospërputhës me shoqërinë: i kundërligjshëm, homoseksual, vegjetarian, mëngjarash, i shpërqendruar, me raste edhe heretik. Firenze lulëzoi gjatë shekullit të pesëmbëdhjetë, sepse ishte komode me njerëz të tillë. Mbi të gjitha, kurioziteti i pashteruar i Leonardos dhe eksperimentet e tij duhet të na kujtojnë rëndësinë e bindjes, si për veten ashtu edhe për fëmijët tanë, që të mos marrin thjesht dije, por të jemi të vullnetshëm ta analizojmë atë - të jemi krijues dhe si njerëz të talentuar, mospërputhës dhe rebelë të çdo epoke, të mendojmë ndryshe. /Exlibris

Përkthyer nga Bledar Kurti

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com




QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Miqësorja ndaj Suedisë, test i mirë për Kosovën

Kosova e zhvillon të dielën miqësoren ndaj Suedisë, kurse ky po vlerësohet një test i mirë për futbollistët "dardanë" që janë ftuar për herë të parë në Përfaqësuese. Përzgjedhësi Bernard Challandes e vlerëson në maksimum kundërshtarin, kurse shprehet i lumtur se për këtë ndeshje janë grumbulluar edhe lojtarë nga Superliga



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 10 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll nesër (e diel) do ta zhvillojë ndeshjen miqësore ndaj Suedisë. Ndryshe nga herët e tjera, përzgjedhësi Bernard Challandes, në mesin e 25 futbollistëve, 13 i ka ftuar nga Superliga e Kosovës. Strategu zviceran në një intervistë për gazetën "Epoka e re" kishte deklaruar se kjo miqësore është e mirëseardhur për "dardanët", pasi do ta kenë mundësinë të paraqiten edhe disa nga lojtarët që aktivizohen në kampionatin vendor. "Kemi pranuar këtë mundësi për të luajtur këtë ndeshje me Suedinë B, pasi është një ekip i fortë dhe ka lojtarë të ndryshëm që luajnë në skuadrat si Jaenkopins, Malmo, ku bëjnë pjesë në një ligë të fortë. Neve na është dhënë një mundësi për të parë lojtarë të ri që luajnë edhe në ligën e Kosovës. E kam pranuar këtë ofertë për ndeshjen me Suedinë, sepse ne kemi menduar me drejtuesit e federatës se është një mundësi e mirë për të parë lojtarë që luajnë

edhe në Kosovë", kishte deklaruar Challandes.

Në mesin e të ftuarave është edhe mesfushori me përvojë të madhe, Herolind Shala, i cili në ndeshjet e fundit kualifikuese mungoi për shkak të lëndimit. Ai ka treguar se po ndihet mirë fizikisht, kurse për ndeshjen me Suedinë ka thënë se është e mirëseardhur për faktin se disa lojtarë të rinj mund t'i tregojnë vlerat e tyre para trajnerit Challandes. "Personalisht e ndiej veten jashtëzakonisht mirë që jam rikthyer pas lëndimit dhe që sërish jam pjesë e Përfaqësueses. Çdoherë kur grumbullohem me ekipin ndihem krenar dhe i lumtur. Kësaj radhe ka edhe shumë lojtarë të ri dhe më vjen mirë që u është dhënë mundësia ta përfaqësojnë Kosovën në këtë miqësore. Mendoj se kemi kohë të mjaftueshme deri të dielën për ta përgatitur lojën tonë sa më mirë dhe pres një lojë cilësore. Natyrisht se miqësorja me Suedinë është një test i mirë, por edhe një mundësi për futbollistët e rinj që t'i tregojnë cilësitë para përzgjedhësit Challandes", ka thënë Shala.

I ftuar për këtë ndeshje miqësore është edhe futbollisti Rron Broja, i cili është shumë i lumtur se i është dhënë rasti të grumbullohet nga Përfaqësuesja A. "Është ndjenjë e veçantë të jesh pjesë e Kombëtares. Ashtu sikurse shumica e futbollistëve të tjerë në këtë grumbullim, edhe unë ndihem shumë i lumtur që jam ftuar për këtë miqësore", ka thënë Broja, i cili është shumë optimist se futbollistët "dardanë" do të paraqiten mirë dhe do të marrin një rezultat pozitiv edhe përkundër asaj që luajnë ndaj një kundërshtari të fortë. "Shpresoj që kundër Suedisë do të tregojmë lojë të mirë dhe nuk do të zhgënjëjmë as me rezultat. Gjithsesi, duhet vlerësuar organizimin e kësaj miqësoreje, e cila na ka dhënë mundësi neve si futbollistë që t'i tregojmë vlerat tona në një ndeshje të nivelit të tillë", ka shtuar ai.

Ndeshja me Suedinë zhvillohet nga ora 15:45 në kohën lokale në Kosovë, derisa është testi i fundit para ndeshjes gjysmëfinale që Kosova e zhvillon në muajin mars në Ligën e Kombeve ndaj Maqedonisë Veriore.

Edhe katër lojtarë do të largohen nga Milani

Milani po bën një revolucion total këtë merkato, teksa shumë lojtarë po largohen nga klubi kuqezi. Serinë e largimeve e hapi Fabio Borini të enjten, i cili zgjodhi Veronën. Pas tij ishte dhe Mattia Caldara, i cili kaloi tek Atalanta në huazim me të drejtë blerje për 15

milione euro. Vetëm këto dy largime janë zyrtare, por gjithsesi nuk mbaron me kaq, pasi janë edhe katër lojtarë të tjerë me valixhe në duar. Ricardo Rodriguez është vetëm një hap larg kalimit te Fenerbahçe, njësoj si Reina e Piatek, të cilët kanë si destinacion Premierë

Ligën. Spanjoli pritet ta zgjidhë kontratën dhe të kalojë tek Aston Villa, ndërsa polaku do të kalojë te Tottenhami për 35 milionë euro. Piatek pritet të firmosë një kontratë për tre vjet e gjysmë. Largimi i gjashtë pritet të jetë Franck Kessie, për të cilin interesohen disa ekipe.

SHKURT

Përforcohet KB Prishtina

KB Prishtina ka konfirmuar se është përforcuar me fundorin Jordan Johnson. "Prishtina ka vetëm një objektivi, që të jetë më e mira në vend. Këtë tanimë e kemi dëshmuar. Për ta arritur qëllimin edhe këtë vit ne kemi filluar ta përforcojmë edhe me shumë ekipin. I pari që arrin është fundori Jordan Johnson, një lojtar i dëshmuar në garat evropiane", thuhet në konfirmimin e Prishtinës. Ai së fundmi ka luajtur te skuadra holandeze Landstede Hammers Zwolle me një mesatare prej 16.7 pikëve në kampionatin holandez, ndërsa në Fiba Europe Cup me mesatare 14.7 pikë për ndeshje.

Mazzari lavdëron Ujkanin

Trajneri i Torinos, Walter Mazzari, e ka lavdëruar portierin kosovar Samir Ujkani. Ai e ka quajtur kapitenin e Kosovës një blerje e shkëlqyeshme. "Ujkani është i besueshëm. Ishte blerje e shkëlqyeshme", ka thënë Mazzari. Portieri kosovar ishte transferuar te klubi italian si lojtar i lirë pas largimit nga Rizespori.

Arteta bllokon largimin e Xhakës nga Arsenali

Mikel Arteta e ka bindur Granit Xhakën që të qëndrojë në Arsenal. Mesfushori me origjinë shqiptare nuk kaloi momente shumë të mira te "Topçinjtë" që pas përplasjes me tifozët. Qëkur mori drejtimin e Arsenalit, Arteta ka dalë në mbrojtje të 27 vjeçarit. Xhaka ishte një lojtar kyç për Artetën. Tekniku spanjoll arriti ta bindte Xhakën që të mos largohej nga Arsenal kur kishte edhe oferta nga Hertha e Berlinit. Zënka mes tifozëve dhe Xhakës nisi në tetor në ndeshjen kundër Crystal Palace. "E di se si ndihet në këto çaste, por unë dua që ai ta dëgjojë opinionin tim për të. Është shumë e vështirë që në një vit gjithçka të shkojë në mënyrë të përkryer. Shpresoj që të gjithë ta harrojnë atë që ka ndodhur", ka thënë Arteta.

Behrami: Genoa edhe në sezonin tjetër do të luajë në Serinë A

Mesfushori Valon Behrami është i bindur se skuadra e Genoas edhe në edicionin tjetër do të bëjë gara në Serinë A. Ai në një intervistë dhënë të enjten për mediumet italiane ka thënë se Genoa do ta arrijë synimin që ka këtë edicion, shpëtimin nga rënia në Serinë B. Genoa këtë edicion ka rezultate kryesisht të dobëta, kurse Behrami javë më parë është transferuar për ta ndihmuar ekipin në synimin që ka. Genoa aktualisht zë vendin e 18 në Serinë A, që dërgon në një kategori më poshtë, pasi ka tubuar 14 pikë pas 18 xhironëve të zhvilluara. Behrami, 34-vjeçar, deri më tash ka vetëm një paraqitje te Genoa. "Unë i kuptoj kërkesat e tifozëve dhe i siguroj se do ta arrijmë qëllimin këtë edicion, duke luajtur edhe edicionin tjetër në Serinë A", është shprehur Behrami për "Tuttomercatoweb".

Limaj: Ëndërroj të luaj për Kombëtaren e Shqipërisë

KUKËS, 10 JANAR - Futbollisti nga Kosova, Vesel Limaj, duket se ka vendosur që të mos largohet nga Kukësi, të paktën deri në mbyllje të këtij sezoni. Lojtari është zyrtarisht pa një kontratë me verilindorët, pasi ka bllokuar rinovimin automatik të saj, por ai ka nisur stërvitjet rregullisht me ekipin në Antalia dhe nga

fjalët e tij për RTSH duket qartësisht se nuk e mendon largimin nga skuadra ku është kthyer në një nga pikat kyçe. "Besoj se kjo përgatitje na bën mirë, na bashkon edhe si grup sepse kemi një ekip shumë të mirë dhe në Turqi kemi edhe kushte të mira. Titulli kampion? Nuk është e lehtë, sepse jemi akoma në

fazën e dytë. Ka ende kohë, por jemi në rrugën e duhur dhe besoj se do t'ia arrijmë qëllimit. Ky është një kampionat shumë i çuditshëm pasi nuk ka shumë dallime mes ekipeve. Ekipet kundër nesh luajnë me shumë motivim. Normalisht të luash kundër Kukësit është diçka e normalisht edhe ne duhet të

motivohemi më shumë", ka thënë ai. Ndërkaq, titulli nuk është objektivi i vetëm i 22-vjeçarit, i cili i ka hedhur sytë edhe fanellës kuqezi të Shqipërisë e nuk e fsheh që e ka si synim në karrierën e tij. "Është një ëndërr të vesh fanellën kuqezi dhe shpresoj të realizohet kjo ëndërr", ka shtuar Limaj.



Duka: U kërkoi falje tifozëve, gabova me Panuccin

Tiranë, 10 janar - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka, ka dhënë një tjetër intervistë për mediet italiane, këtë herë për gazetën "Tuttosport". Pas intervistës që Duka dha për "Gazzeta Dello Sport" dhe foli për Christian Panuccin, jo me fjalë të mira. Këtë herë edhe në intervistën e tij të dhënë për "Tuttosport" nuk ka pasur gjëra pozitive për të thënë. "Në zgjedhjen e Panuccit kam gabuar tërësisht dhe U kërkoi falje tifozëve. Për ne Kombëtarja është gjëja më e rëndësishme dhe ai e shkatërroi skuadrën. Ai është një njeri me konflikt: ai kurrë nuk do të jetë trajner. Pas çdo ndeshje pati tensione me shtypin, ajo krijoi çarje në ekip. Ai nuk mendon për futbollin, por vetëm për paratë. Kur e njoftova për shkarkimin, menjëherë më tha se do të pretendonte edhe qindarkën e fundit. Nuk është çështje ekonomike, por korrektësi etike", u shpreh Duka. Më tej, ai ka folur për Edoardo Reja teksa është



shprehur: "Reja ishte pak i dyzuar në fillim, kështu që Tare e thirri dhe e bindi që të bëhej trajner i

Shqipërisë. Kemi një projekt të mirë dhe objektivi është që të marrim pjesë në Evropianin e 2024-s".

Oklahoma triumfon ndaj Houstonit

HOUSTON, 10 JANAR - Ishin vetëm katër ndeshje në mbrëmjen e NBA-s, por spektakli dhe emocionet nuk munguan as këtë herë. Vëmendjen më të madhe e mori dueli i "Chesapeake Energy Arena", aty ku Oklahoma City Thunder mposhti lehtësisht me shifrat 113-92 Houston Rocketsin. Një ndeshje e dominuar nga City Thunderi që e pa veten në avantazhin e 16 pikëve që në fundin e periodës së parë. Për ta marrë fitoren e 7-të në tetë takimet e fundit, Oklahoma iu fal 23 pikëve, 11 rikuperimeve poshtë tabelës dhe 4 asistimeve të Danilo Gallinarit. Houstonit në krahun tjetër nuk i mjaftuan 34 pikët e ishit të madh të sfidës Russell Westbrook. Po kalon një minikrizë rezultatesh, Boston Celtics që pësoi humbjen e tretë rresht pasi u mposht në Pensylvani nga Philadelphia 76-ers me rezultatin 109-98. Richardson me 29 pikë ishte heroi i Philadelphia në këtë sfidë që regjistroi fitoren numër 25 në 39 takime. Në krahun tjetër skuadrës më të titulluar të NBA-s nuk i mjaftuan 50 pikët e realizuara nga dyshja Walker-Smart. Buzëqesh edhe Minnesota Timberwolves.



Skuadra nga Minneapolis kaloi me shifrat 116-102 Portland Trail Blazersin për meritë edhe të kanadezit Andrew Wiggins, autor i 23 pikëve. Falë këtij sukcesi dhe ecurisë së mirë që ka pasur në javët e fundit Minnesota është futur fuqishëm për të siguruar një vend në "play-off". Vazhdon rënia e lirë e

Detroit Pistonsit, ndërkohë që i dha fund krizës së rezultateve prej 5 humbesh rresht Cleveland Cavaliersi që fitoi me shifrat 112-115 pas kohës shtesë brenda në Michigan. Më i miri për skuadrën nga Ohio në këtë sfidë ishte kanadezi Thompson me 35 pikë, 14 rebounde dhe 3 asistime.

SHKURT

Simeone: Pas barazimit e ndieja se do ta fitonim

Diego Pablo Simeone ishte thjesht i çmendur, i ekzaltuar dhe sigurisht që festimet e tij tashmë bëjnë bujë në të gjithë botën. Trajneri i Atletico vendosi që ta përmbajë disi veten, duke qenë se fitorja ndaj Barçës thjesht i dhuroi finalen, ndërsa për trofeun duhet të mposhtin edhe Realin. "Ishte një nga ato fitore për të cilat ia vlen të vuash e më pas të fitosh. Ishte një natë madhështore për të gjithë ne dhe është meritë e lojtarëve të mi që ia dolën. Ndoshta s'do ta besoni, por e ndjeva realisht se mund ta përmbysnim. Pas barazimit isha i bindur në kokën time se do ta shënonim edhe golin e tretë dhe intuita nuk më gënjeu. E merituar finalen", ka thënë Simeone.

Erikseni, afër Interit


Ylli danez i Tottenhamit, Christian Eriksen, do të mbetet pa kontratë në fund të këtij sezoni, kurse Interi po synon transferimin e tij. "The Sun" raporton se agjenti i Eriksenit ka udhëtuar drejt Milanos, ku do të takohet me drejtuesit e Interit. Aty do të flitet për një transferim të mundshëm të lojtarit të skuadra 'zikaltër'. Thuhet se Interi mund të arrijë marrëveshje me Tottenhamin, duke paguar 20 milionë funte. Mbetet të shihet nëse do të finalizohet ndonjë marrëveshje që transferon danezin tek Interi.

Messi: Humbëm nga gabimet fëmijërore

Lionel Messi është i zhgënjyer me humbjen e Barcelonës nga Atletico Madridi. Ai bëri me dije se kjo humbje erdhi për shak të gabimeve fëmijërore që bën lojtarët e Barcelonës. "Është e turpshme, bëmë lojë të shkëlqyer, pas një kohe të gjatë u ndiem sërish mirë, e kishim kontrollin, dominuan dhe sulmuam gjatë gjithë kohës. E lëshuam nga dora për shkak të gabimeve të caktuara kur Atletico ndihej i humbur, për më pak se 10 minuta e rikthyen lojën, të cilën ne është dashur ta mbyllnim me kohë", ka thënë Messi. "Dhemb sepse është një titull dhe ne donim të ishim në finale dhe të fitonim. Kemi bërë një hap përpara, përkundër humbjes, por jemi të vetëdijshëm se nuk i kemi bërë gjërat ashtu si duam, nuk duam t'i bëjmë këto gabime fëmijërore", ka shtuar Messi.

Kane mungon deri në prill

Lajm i keq për Tottenham Hotspurin. Skuadra londineze do të duhet të bëjë pa kapitenin e saj për shumë muaj. Me një komunikatë zyrtare, "gjelat" kanë bërë me dije se qendërsulmuesi anglez Harry Kane do t'i nënshtrohet një ndërhyrjeje kirurgjikale si pasojë e frakturës së tenditës së gjurit të majtë. Kane u lëndua në takimin kundër Southamptonit në ndeshjen e parë të Vitit të Ri dhe do të kthehet në dispozicion të trajnerit Jose Mourinho vetëm në muajin prill. Nga ky moment e më tej, kapiteni i përfaqësueses së "Tre Luanëve" do të kryejë një proces riaftësimi për të qenë gati për Kampionatin Evropian.



Autor: GAZMEND MORINA	BIMË BARISHTORE QË KA VLERA TË MËDHA USHQIMORE	QULL I TRASHË ME MIELL MISRI	QYTET NË ITALI	MJET I MADH LUNDRIMI (shq.)	PJESA E ERRËT E DITËS	ZANORE	PËR MË TEPËR, MADJE	EPOKA ERE	KRYEQYTETI EVROPIAN I MODËS	QË U PËRKET PARAARDHËSVE TONA	GAZETË QË BOTOHET NË SHQIPËRI
ENË QELOI E RRUMBULLAKËT SI SHISHE, PO ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK								AKTORI HOLLIVUDIAN BRED ... BASHKËT.			
FUSHA KU ZHVILLOHET NJË PËRLESHJE						JETËSHKRIM ZANORE					
GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)								VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE FUTBOLLISTI ÇEK BAROSH			
KRAHINË NË KOSOVË						DRAMË E SANTORIT E SPËRKAT ME UJË					
FILMI I PARË SHQIP						MUZIKANTI PRESHEVA (shq.) HIT NGA GRUPI "NRG BAND"					BASKETBOLLISTI YNË EDMOND
					DY BASHKËTINGËLLORE DHELPARAK		PORTIERI ILION SHTEGTARE				
GOCA	TELEVIZORI KONTROLLUES	ISMET RAMUSHI	KËNGËTARJA E FAMSHME ROSS KËNGËTARJA AMERIKANE ... KIM					EDA ZARI KËNGËTARJA KANADEZE MORISSET			

EPOKA ERE	KËNGËTARJA ANGLEZE NË FOTO	DËMTIM I NJË MAKINE GJATË KOHËS SË PUNËS	SKENARISTI JETON	JO I VJETËR	EPOKA ERE	KANDËRR E VOGËL ME NGJYRË TË ZEZË "MOLDE"						ESTONIA ZANORE
ISH AKTORI PALLASKA	○				AKTORI ADRIAN FLETË LETRE PËR DUHAN				BASHKËT. KOHË E NDARË PËR PUNË		KUNDREJT MJERË ZENEL OSMANI	
KLUB FUTBOLLI ANGLEZ	○				NOTË MUZIKORE EMËR MASHKULLI TURK			GJELBËRIMI NË NATYRË TRAJNERI GJERMAN REHAGEL			ISTRES SHKRIMTARI SHEHU (shq.)	
PAJTUESHMËRIA (krah.) BUKURIA, HIJESHIA (krah.)	○				PËREMËR PRONOR ZANORE	VARG NJE-RËZISH NË VIJË TË DREJTË (shq.) GRADE USHTARAKE					PERSIA E SOTME	
→ ○				SERË "INDONEZIA"			TANTAL, ELEKTRON FILOZOF NË GREQINË ANTIKE			ARAP ERMELINDA MEKSI		
KLUB I YNI FUTBOLLI	○				GOJËTAR POROSIA E FUNDIT					KUNDËRSH-TAR I BOLSHEVIZMIT RUS DESPOTIK		
BASHKËT.	○	KRYEQYTETI I NJË SHTETI EVRO-AZIAK NJË LLOJ SHPATE JO SHUMË E MADHE						SHTET NË AZI (pashq.)	MIMOZA MUSTAFA QYTET NË KOSOVË		TONI ADAMS SHUMË E LODHUR, E KËPUTUR	
"O" para dy "J"	○			SUPER MODELJA KANADEZE JESSICA	TËRËSI E MITEVE TË NJË POPULLI ISH PORTIERI GJERMAN OLIVER ...					EMPLOYER IDENTIFICATI. NUMBER ISLAM MUSA		
LLUKA ANTONINI	○		NUK KA (bised.) I FILLUAR			ZANORE	BARAZIM NË SHAH DOLLAP PËR TË MBAJTUR ZOGJ (shq.)				ZANORE ISH TRAJNERI YNË I BOKSIT LAH	
EPOKA ERE	SHUMË I MADH DHE I FUQISHËM ARTI VALLEVE ME FIGURA (pashq.)						FUTBOLLISTI KALOU (CHELSEA) QË LIDHET ME DITËN					LLOJ VEGLE MUZIKORE (sh.shq.)
PEMË E VENDEVE TROPIKALE					AFËRDITA DEMAKU KËNGËTARJA ... KOÇI			SHEGË FUTBOLLISTI TOURE (MANCHESTER CITY)			REPERJA JONË ... VLORA NATIONAL UNION TEACHERS	
POETI VINCA					FUTBOLLISTI SHQIPTAR OSMANI OSMAN (perkdh.)			AGJËRIMI (krah.) RINOR (perkdh.)				
"... VEGAS"				XEHETAR KALJARI, ANKONA					PIRAT NOTË MUZIKORE			
E KËPUTA (krah.)					VEÇIM NGA RRETHI KU JETOJMË ZANORE					KËNGËTARJA ALTUNA SEJDIU BASHKËT.		
KRYEQYTETI SHQIPTAR						SATIRIK					TËRËSI E VEPRIMEVE TË NJË KULTI FETAR	

ZGJIDHJA E FJALËKRËSIT: KAVANUZ, PIT, ARËNA, ANALE, RARITET, RIM, OPOJA, EMIRA, TANA, ENISI, VASHA, RL, LIKA, DIANA, EZ, MILINGONA, E, SHANI, MORINA, M, LUM, EVERTON, LA, OAZA, I, RAZIA, IM, KORDONI, HIRI, BITUM, TAE, IZI, LIRIA, ORATOR, ESER, K, ANKARAJA, MM, TA, OJJ, MITOLOGJI, EIN, LLA, SKA, REMIZIM, I, TITANIK, SALOMON, BANANE, AD, NAR, LIL, AGIM, TEFIK, NIMMI, LAS, MINATOR, KUSAR, E NUKA, IZOLIM, TUNA, TIRANA, IRONIK, RIT.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "ASL", SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër Unik të Biznesit: 810815417 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë Korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "ASL" D.O.O. od Pristina, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom unik: 810815417 i ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "ASL" L.L.C. in Prishtina, has come to the decision to quit its business unik: 810815417 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

N J O F T I M

K.R.M." ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË,
ANULON pjesërisht Konkursin e publikuar me datë 24.12.2019, për këto pozita:

1. Zyrtar/e për Informim, dhe
- 2 Arkëtar/e.

Ky anulim bëhet për shkaqe teknike.

Drilon Vojvoda, B.I.
shpall të pavlefshëm
Certifikatën e biznesit
me nr. NRB. 71360970
me seli ne Llaushë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Touch Investment" Sh.p.k Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e kompleksit turistik dhe objekteve shtëpi banimi (turizëm fshatar) në Prevallë komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05. 02. 2020 në ora 11:00 në lokalet e hotel "Morea" në Prevallë komuna e Prizrenit do të organizohet debat publik nga kompania "Touch Investment" Sh.p.k Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e kompleksit turistik dhe objekteve shtëpi banimi (turizëm fshatar) në Prevallë komuna e Prizrenit.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Fabrika Mobileve Standard" Sh.p.k Bajë, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e mobileve ne fshatin Banjë komuna e Malishevës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07. 02. 2020 në ora 11:00 në lokalet e fabrikës "Standard" fshati Banjë komuna e Malishevës do të organizohet debat publik nga kompania "Fabrika Mobileve Standard" Sh.p.k Bajë, Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën për prodhimin e mobileve ne fshatin Banjë komuna e Malishevës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Telekomi i Kosovës, Sh. A.

Në mbështetje të Ligjit të Punës 03/L-2012 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Sektorin Publik (MPMS) Nr. 07/2017 të Republikës së Kosovës, Rregullores për Marrëdhënie Pune 01/6352/19 datë 29.11.2019, me qëllim të funksionalizimit dhe funksionimit të mirëfilltë të procesit të punës, Telekomi i Kosovës Sh. A. shpall:

KONKURS PËR VEND PUNE

□ **Vendi i Punës : Ekspert i Sigurisë së Rrjetit dhe Platformave të Telekomit të Kosovës – Një ekzekutues-Grada 14**

Konkursi është i hapur për të gjithë të interesuarit që përmbushin kushtet dhe kriteret e kërkuara e që dëshirojnë të behën pjesë e Telekomit të Kosovës, Sh. A.

Mënyra e aplikimit:

- Kandidatët duhet ta plotësojnë Aplikacionin për Punësim, që gjendet në www.kosovotelecom.com, një CV të detajuar, dëshmi për punësim, kualifikimet, letër motivuese.
- Aplikacionet mund të parashtrihen në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.
- Aplikacionet duhet të dorëzohen në Arkivin e TK-së, kati VI zyra 603, deri në afatin e paraparë për aplikim me shenjë "PËR KONKURS" duke e cekur titullin e vendit të punës për të cilin aplikon.
- Afati i fundit për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit. Data e fundit për aplikim është 25/01/2020 ora 16:00
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kualifikimi, përvoja dhe të tjera:

- Diplome universitare në fusha përkatëse. Njohja e gjuhës angleze obligative. Se paku 3 vite përvojë në nivelin e sigurisë kibernetike, përvojë të dëshmuar për:
 - Haker etik i certifikuar (Certified Ethical Hacker)
 - Siguri Kibernetike
 - Rrjeta Kompjuterike
 - CompTIA Security+ (certifikim ndërkombëtarë për siguri në kibernetikë)
 - Sisteme Operative Windows/Linux
 - Linux Siguria
 - Testimi i ndërhyrjeve të paautorizuara
 - Njohuria themelore e sigurisë së kompjuterit (Fundamental of Computer Security)
 - Hakimi (qasja e paautorizuar) me Wireless (internet pa përcues) dhe siguria

DETYRAT E PUNËS DHE PERGJEGJESITË:

- Testimi i depërtimit të paautorizuar në sistem dhe analiza e cenueshmërisë si të rrjeteve të brendshme ashtu edhe të atyre të jashtme/ (Penetrating Test and vulnerability analyses of both internal and external of the networks
- Instalimi i "Firewall" dhe mirëmbajtja (Checkpoint, PIX, Smoothwall, IPchains, IPTables) / (Firewall installation and maintenance (Checkpoint, PIX, Smoothwall, IPchains, IPTables)
- Sistemi për zbulimin e qasjes së paautorizuar (krijimi i modelit, mbështetja, admin.) / Intrusion Detection Systems (setup, support, administration) (Netranger, Snort, RealSecure, SecureNet Pro, other's)
- Dokumentimi i procedurave dhe praktikës për IT-në e përgjithshme si dhe sigurinë e IT-së dhe procedurat e korporatave / Documentation of procedures and practices for both general IT as well as IT Security and corporate policy.
- Zbatimi i Drejtoratit aktiv dhe siguria / Active Directory Implementation and security
- Hulumtimi efikas i produktit dhe shkathtësitë për blerje / Effective product research and purchasing skills
- Modelimi i topologjisë të rrjetit dhe zbatimi i tij
- NT 3.51 dhe 4.0, 2000, .NET Serverët dhe stacionet e punës / Servers and Workstations, Windows 95, 98, ME, Windows 3.X, and DOS, XP
- Serveri për informacione të Internetit / Internet Information server (Microsoft IIS) versioni 1.0, 2.0, 3.0, 4.0, 5.0
- Instalimi dhe mirëmbajtja e shërbimeve VPN
- Skaneri CyberCop Scanner, skaneri CIS/Typhon, Saint, Sara, skaneri i Ueb trendeve të sigurisë, Nessus
- Serveri Microsoft SQL Server 6.5, 7.0, dhe 2000
- Lloje të ndryshme të serverëve, duke përfshi Compaq, HP, Acer, Dell, Gateway 2000, Micron and Clones / Wide variety of servers including Compaq, HP, Acer, Dell, Gateway 2000, Micron and clones
- Cisco Switches, Routers, Bridges, Hubs (10 MBPS, 100 MBS, and Gig)
- Backup-at (kopjet e shënimeve) për rrjeta dhe për rivendosje të gjendjes së mëparshme pas ndonjë avarie të madhe duke i shfrytëzuar/ Network backups and disaster recovery utilizing Backup exec, ARCserve, Palindrome and Legato on NT, Unix and Novell Platforms
- NNTP, FTP, HTTP, POP3. SMTP – protokollet dhe serverët
- Zhvillimi dhe modelimi i ueb faqes / Webpage development and design
- Aftësi për mësimdhënie dhe mentorim të ndonjë niveli të përvojës prof./ Ability to teach and mentor to any experience level
- Dokumentimi teknik / Technical documentation
- Mbrojtja nga viruset dhe largimi i tyre në ndërmarrje/ Virus Protection and removal in the Enterprise
- Konfiguracioni LAN/WAN/ LAN/WAN Configuration



Telekom Kosova A.D

U skladu sa Zakonom o radu br. 03/L-2012 i na osnovu Administrativnog uputstva o regulisanju postupaka za konkurs u javnom sektoru (MRSZ) br. 07/2017 Republike Kosovo, Pravilnika o radnom odnosu 01/6352/19, od 29.11.2019.g. u cilju funkcionalizacije i pravilnog funkcionisanja radnog procesa, Telekom Kosova a.d. raspisuje:

KONKURS ZA RADNO MESTO

□ **Radno mesto : Stručnjak za sigurnost mreže i platformi Telekom Kosova – jedan izvršilac-stepen 14**

Konkurs je otvoren za sve zainteresovane koji ispunjavaju zahtevane uslove i kriterijume, a koji žele da budu deo Telekom Kosova a.d.

Način prijavlivanja na konkursu:

- Kandidati treba da popune obrazac za prijavu na konkursu, koji mogu naći na stranici www.kosovotelecom.com, poslovna biografija (CV) sa pojedinostima, dokaz o zaposlenju, kvalifikacije, motivaciono pismo.
- Prijave se mogu popuniti i podneti, na jednom od zvaničnih jezika Republike Kosova.
- Prijave treba predati u Arhivi KT-a, VI sprat, kancelarija br. 603, u predviđenom roku za prijavljivanje uz naznaku: ZA KONKURS, i uz navođenje naziva radnog mesta za koji konkuriše.
- Zadnji rok za prijavljivanje je 15 dana od raspisivanja konkursa. Zadnji rok za prijavljivanje na konkursu je 25/01/2020.g. u 16:00 časova.
- Prijave podnete nakon predviđenog roka, neće se prihvatiti, dok će se nepotpune prijave odbaciti.

Kvalifikacija, radno iskustvo i ostalo:

- Diploma univerziteta u odgovarajućem polju. Poznavanje engleskog jezika je obavezno. Najmanje 3 godine radnog iskustva na nivou kibernetičke sigurnosti, dokazano iskustvo kao:
 - Sertifikovani etički haker
 - Kibernetičku sigurnost
 - Kompjuterske mreže
 - CompTIA Security+(međunarodna sertifikacija za sigurnost u kibernetici)
 - Operativna platforma sistema Windows/Linux
 - Linux sigurnost
 - Test za upad u drugi sistem
 - Osnove sigurnosti kompjutera
 - Bežično hakiranje i sigurnost

RADNI ZADACI I ODGOVORNOSTI:

- Test u vezi sa neovlašćenim upadom u sistem i analiza ranjivosti (povredljivosti) kako unutrašnjih mreža tako i spoljnih mreža;
- Instalacija i održavanje „Firewall-a“ (Checkpoint, PIX, Smoothwall, IPchains, IPTables)
- Sistem za otkrivanje neovlašćenog pristupa (upada) sistemu (izrada modela, podrška, administracija) (Netranger, Snort, RealSecure, SecureNet Pro, ostali)
- Dokumentovanje postupka i prakse kako za opšti IT tako i za sigurnost IT-a i postupak (politika) korporacije.
- Sprovođenje Active Directory i sigurnost
- Veštinu za efikasno istraživanje proizvoda i veštinu nabavke (kupovine)
- Modeliranje i sprovođenje mape mreža
- NT 3.51 i 4.0, 2000, .NET Serveri i radne stanice (Workstations), Windows 95, 98, ME, Windows 3.X, and DOS, XP
- Server za Internet Informacije (Microsoft IIS) verzija 1.0, 2.0, 3.0, 4.0, 5.0
- Instalisanje i održavanje VPN usluga
- CyberCop skener (Scanner), CIS/Typhon skener (scanner), Saint, Sara, sigurnost ueb trendova (WebTren Security) Skener trenda sigurnosti (Trends Security Scanner), Nessus
- Microsoft SQL Server 6.5, 7.0, i 2000
- Široka raznolikost servera uključujući Compaq, HP, Acer, Dell, Gateway 2000, Micron i clones
- Cisco Switches, Routers, Bridges, Hubs (10 MBPS, 100 MBS, and Gig)
- Rezervna kopija mreže i oporavak od teških kvarova (katastrofa) uz korišćenje Backup exec, ARCserve, Palindrome i Legato u NT, Unix i Novell Platforme
- NNTP, FTP, HTTP, POP3. SMTP – protokoli i serveri
- Izrada (razvoj) i modeliranje ueb stranice
- Sposobnost za obuku i nošenje uloge mentora u bilo kom nivou radnog iskustva
- Tehničko dokumentiranje
- Zaštita od virusa i njihovo uklanjanje u preduzeću
- Konfiguracija LAN/WAN

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "IP - KOS" Sh.p.k. Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve, rruga "UÇK", Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2020 në ora 10:30 në hapësirat e restorant "Gresa" afër stacionit të derivateve IP KOS rruga "UÇK", Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania "IP - KOS" Sh.p.k. Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve, rruga "UÇK", Prishtinë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "IP - KOS" Sh.p.k. Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve, rruga "Hamëz Jashari", Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2020 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Gresa" afër stacionit të derivateve IP KOS rruga "UÇK", Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania "IP - KOS" Sh.p.k. Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve, rruga "Hamëz Jashari", Prishtinë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "IP - KOS" Sh.p.k. Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve, rruga Prishtinë-Fushë Kosovë në Prishtinë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 06.02.2020 në ora 11:30 në hapësirat e restorant "Gresa" afër stacionit të derivateve IP KOS rruga "UÇK", Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania "IP - KOS" Sh.p.k. Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve, rruga Prishtinë-Fushë Kosovë në Prishtinë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "VIZIONI INFO" SH.P.K. shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit me numër 601723829.

► Elheme Qorraj shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. "Emin Duraku" Likoc.

► "ASL" SH.PK. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

► Veton Shaqiri, shpall të pavlefshme dëftesat e SHF. "Deshmoret e Qyqavices" Qirez.

► Astrit Shaqiri, shpall të pavlefshme dëftesat e SHF. "Deshmoret e Qyqavices" Qirez

► Lirije Brahimi, shpall të pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHF. "Azem Bejta" Prekaz i Eperm.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistrallja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

